

Plani i Veprimit Kundër-Korrupsion:

Prioritet social dhe ekonomik për Kosovën

Tetor 2006



Plani i Veprimit Kundër-Korrupsion:

Prioritet social dhe ekonomik për Kosovën

Tetor 2006

Vërejtjet hyrëse

Secili prej Kryeministrave të IPVQ-ve, me të marrë postin, e kanë përcaktuar luftën kundër korrupsionit si prioritetin kryesor për Kosovën. Kjo luftë është një ushtrim i shëndoshë dhe i nevojshëm për të forcuar besimin në institucione dhe t'ia mundësojë popullit të Kosovës themelimin e një demokracie të qëndrueshme.

Baza për arritjen e këtij qëllimi është vendosur me miratimin Stretegjisë gjithpërfshirësë për Anti-Korrupsion dhe Planit Veprues për Anti-Korrupsion, që përmbajnë një grup masash në nivelin legjislativ, administrative, gjyqësore dhe policor. Ajo po ashtu ofron mundësi për iniciativa ndaj shoqërisë civile, siq është ofrimi i informatave për statusin e luftës kundër korrupsionit.

Punëtoritë që janë organizuar dhe janë planifikuar, paraqesin një përpjekje të përbashkët të Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe Zyrës së Kryeministrit. Këto punëtori kanë arritur që për herë të parë të mbledhin në një vend të gjitha palët të përfshira në zbatimin e Planit Veprues me përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Ky dokument, i cili po ashtu paraqet një iniciativë të përbashkët, ofron informacione të azhurnuara prej ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë për gjendjen aktuale të korrupsionit në Kosovë, perceptimin e opinionit publik të saj, si dhe hapat e parë në luftën kundër korrupsionit. Ajo mundohet t'ia sqarojë popullatës shkaqet rënjësore të korrupsionit dhe mënyrat për çrrënjosjen e tij. Veç tjerash, ky dokument mendohet t'i ndihmoj institucionet e Kosovës në zbatimin e Planit të Veprimit.

Korrupsioni nuk është përcaktim që duhet të qëndroj përgjithmonë. Njëherë kur arsyet bëhen të njohura, ato do të mund edhe të adresohen. Plani Veprues, diskutimet publik gjatë punëtorive, si dhe dokumentacioni i ofruar, paraqesin orvatje për shtytjen e shoqërisë Kosovare në vendosjen e demokracisë së mirëfilltë.

Werner Wnendt
Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë

Agim Çeku
Kryeministër i Kosovës

Përmbajtja

Agjensioni Kosovar i Antikorrupsionit
Hasan Preteni, Drejtor i Agjensionit Kosovar të Antikorrupsionit 8

Corruption in Kosovo – features, opinions and challenges
Muhamet Mustafa dhe Ekrem Beqiri, Riinvest 11

Luftimi i korrupsionit në Kosovë
Fron Nahzi,, East-West Management Institute 25

Luftimi i Korrupcionit në Kosovë
Franklin De Vrieze, OSBE në Kosovë 31

Rreziku nga Korrupsioni: Mendime dhe Realiteti
Habit HAJREDINI, Drejtor, Zyra për Qeverisje të Mirë 38

Agjensioni Kosovar i Antikorrupsionit

Hasan Preteni,

Drejtor i Agjensionit Kosovar të Antikorrusionit

Agjensioni Kosovar i Antikorrupsionit, në vazhdim të tekstit AKA është organ i pavarur i cili ushtron përgjegjësitë e përcaktuara me "Ligjin kundër Korrupsionit" Nr. 2004/34.
AKA në Kosovë ka filluar punën më 17.07.2006 - me zgjedhjen e drejtorit. Aktivitetet primare të drejtorit janë të përcaktuara në Organogramin e Institucionit dhe në përcaktimin e rregullave procedurale të punës. AKA me ndihmën e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare do të jetë në funksion të plotë 6 muaj (pasi që të jetë zgjedhur Drejtori i AKA).

AKA është një institucion shumë i rëndësishëm i Kosovës. Veprimtaria e tij do të varet shumë nga përkrahja e insitucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Brenga kryesore e të gjithë kosovarëve-në aspektin politik, është statusi final i Kosovës, kurse në aspektin e "brendshëm" brengat kryesore janë papunësia dhe korrupsioni. Lufta kundër korrupsionit do të jetë argumenti kryesor para Komunitetit Ndërkombëtar se sa janë kosovarët të gatshëm të krijojnë shtet, të vetëdijësohen, t'u bashkohen shteteve të qytetëruara të Evropës, të krijojnë institucione demokratike dhe të pavaruara.

Idetë e drejtorit të AKA për veprim në afatin 5- vjeçar

Për të realizuar misionin e saj, AKA duhet të jetë:

a) e pavarur
b) profesionale
c) me strukturë të profilizuar
d) e hapur për bashkëpunim
e) transparente
f) mirë e paguar

a) E PAVARUR

Pavarësia nënkupton mosndikimin e spektrit politik në veprimin e saj, kuadri profesional duhet të jetë jashtë ndikimeve të partive politike, grupeve të interesit apo grupeve tjera joformale. Bartësit e aktiviteteve në AKA nuk duhet të jenë ata persona të cilët në biografinë e tyre mund të kenë njolla apo aktivitete kriminale. E kaluara e bartësve te aktiviteteve në AKA dhe e familjeve të tyre duhet të jetë dëshmi e fortë te qytetari i kosovës që të mund të mbështesë dhe përkrahë këtë Institucion. Objekti, në të cilin ushtron veprimin AKA, duhet të jetë i ndarë prej objekteve tjera të Qeverisë, prej Kuvendit apo ndonjë institucioni tjetër shtetëror. Ushtrimi i veprimtarisë në një objekt me institucionet tjera, paraqet rrezikshmëri të vazhdueshme për krijimin e raporteve në mes të të punësuarve, ku konflikti i interesave mund të paraqesë gjithmonë rrezik për moszbatueshmëri të ligjit.

b) PROFESIONALE

Bartësit e aktiviteteve në AKA duhet të jenë mirë të trajnuar, profesionalisht të përgaditur dhe të kenë njohuri profesionale për funksionalizimin e sistemit juridik në vend. Rëndësi të veçantë duhet t'i përkushtohet trajnimit të të rinjve, të cilët përgaditjen shkollore e kanë arritur edhe jashtë vendit. Njohja e gjuhëve të huaja (anglishtës në veçanti) njohja perfekte e kompjuterit, njohja e sistemit juridik dhe detyrat e veçanta në AKA, janë parametër i fortë për arritjen e suksesit. AKA duhet të përgadisë strategjinë e Kosovës kundër korrupsionit ose të amandemantojë egzistuesen. Njëherit duhet të propozojë ndryshime sistematike të sistemit juridik dhe, duke propozuar ndryshime, të ndikojë në zvoglimin apo pamundësinë e korrupsionit. AKA duhet të marrë pjesë (së bashku me organizatat dhe shoqatat tjera joqeveritare) në parandalimin e korrupsionit. AKA gjithashtu duhet të marrë pjesë dhe të këshillojë gjatë hartimit të platformës së kodit të etikës në sektorin publik dhe privat.

c) ME STRUKTURË TË PROFILIZUAR

Struktura e AKA duhet të mbulojë të gjitha sferat e veprimit. Struktura të përcaktohet në bazë të detyrave që i obligon ligji. Struktura nuk duhet kopjuar nga asnjë institucion tjetër, por duke i shfrytëzuar praktikat e agjensioneve simotra në rajon, detyrat e përcaktuara me ligj dhe buxhetin e ofruar, të krijohet një strukturë funksionale. Shtrirja e AKA duhet të jetë horizontale dhe vertikale. Me shtrirje horizontale nënkuptojmë formimin e një qendre të fortë dhe stabile në nivel të Kosovës, kurse me shtrirjen vertikale nënkuptojmë funksionalizmin e qendrave nëpër regjionet e Kosovës-deri në nivel të komunave.

d) E HAPUR PËR BASHKËPUNIM

AKA duhet të bashkëpunojë me të gjitha strukturat vendore dhe ndërkombëtare të cilat për mision kanë luftën kundër korrupsionit, si dhe të shfrytëzohen të arriturat e shteteve të cilat kanë kaluar me sukses fazën e tranzicionit nga sistemet totalitare në atë demokratikë, të cilat kanë bartur titullarin e pronës nga ajo shoqërore e shtetërore në atë private. T'i shfrytëzojmë praktikat e shteteve që u janë bashkangjitur apo janë në prag te bashkangjitjës së Bashkësisë Europiane.

AKA duhet të bashkëpunojë edhe me institucionet edukative të vendit, të organizojë seminare dhe tryeza të ndryshme, me qëllim të edukimit të shtresave të gjera dhe që lufta kundër korrupsionit mund të luftohet vetëm me angazhimin e të gjithëve. AKA duhet t'i paralajmërojë autoritetet e Kosovës për realizimin e detyrimeve që dalin nga aktet ndërkombëtare dhe t'u ofrojë rekomandime se si të përmbushen ato. Rëndësi të veçantë duhet t'i përkushtohet bashkëpunimit me institucionet gjyqësore dhe policore, të cilat veprat korruptive duhet t'i trajtojnë shpejt dhe saktë.

Duhet menduar edhe për krijimin e organeve profesionale si në prokurori, ashtu edhe në gjyqësi, të cilat do të merren vetëm me luftën kundër korrupsionit.

e) TRANSPARENTE

Puna e AKA duhët të jetë transparente. Publikimi i veprimeve korruptive në institucionet e larta do të rriste besimin e qytetarëve te AKA dhe institucionet tjera. AKA duhet të hapë një "web" faqe dhe të sigurojë një lidhje të hapur telefonike, ku qytetarët e Kosovës do të mund të raportojnë rastet korruptive.

f) MIRË E PAGUAR

Të punësuarit në AKA duhet të jenë mirë të paguar. Paga e tyre duhet të jetë nga buxheti i konsoliduar i Kosovës - e mjaftueshme për sigurinë e mirqenjes së tyre dhe familjeve të tyre, si dhe te jetë stimulues për angazhimin e profesionistëve në të.
Vetëm njerëzit e paguar mirë mund të jenë garant se nuk do të korruptohen dhe do të japin maksimumin në detyrat profesionale.
Buxheti i Kosovës duhet të jetë garantues i mirë për veprimin e AKA edhe për dëmshpërblimin e atyre që luftojnë korrupsionin. Në luftë kundër korrupsionit nuk duhet kursyer mjetet financiare, sepse ato do te kthehen shumëfish. Personeli profesional duhet të ketë tretman të veçantë edhe në prokuri dhe gjykata

PËRFUNDIM

Lufta kundër korrupsionit në Kosovë do të fitohet vetëm nëse ajo fiton karakter gjithënacional dhe nëse këtë luftë pakompromis e përkrahin institucionet e Kosovës. Vetëdija qytetare duhet të ngritet në nivelin europian. Tek të gjithë duhet të krijohet një bindje e përgjithshme se duke lufuar korrupsionin, ne luftojëm për: mbrojtjen e rendit ligjor, të demokracisë dhe të drejtave të njeriut, qeverisjes së mirë, ndershmërisë dhe drejtësisë sociale, konkurrencës, rritjes ekonomike, besimit të përgjithshëm tek institucionet publike dhe vlerave morale të shoqërisë. Luftën kundër korrupsionit mund ta fitojmë nëse i lajmërojmë të gjitha rastet dhe nëse në këtë luftë kyçen të gjithë.

Korrupsioni në Kosovë – veçoritë, opinionet dhe sfidat

Muhamet Mustafa, dhe Ekrem Beqiri, Riinvest

Abstrakt

Ky punim paraqet një përpjekje për t'i ndriçuar dhe analizuar disa nga karakteristikat e dukurisë së korrupsionit në Kosovë.

Në punim janë analizuar: i) faktorët e përgjithshëm të cilët e karakterizojnë shoqërinë e tanishme kosovare në pikëpamje të rrethanave që i kontribuojnë shtrirjes së dukurisë së korrupsionit; ii) disa rezultate të sondazheve të percepcionit të publikut mbi korrupsionin; dhe iii) sfidat lidhur me luftimin e korrupsionit.

Punimi është pjesë e një raporti më të gjerë, të realizuar me mbështetjen financiare të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (SOROS) në kuadër të një projekti më gjithëpërfshirës të studimit të gjendjes së korrupsionit në Kosovë.

1. Konteksti

Korrupsioni është dukuri shumëdimensionale dhe po aq i vjetër sa edhe njerëzimi. Është në natyrën e njeriut që të mundohet të krijojë privilegje dhe përftime personale pa marrë parasysh nevojat e tjerëve, qoftë edhe në disfavor të tjerëve. Në këtë kuptim nuk përjashtohen as segmente të caktuar të shoqërisë kosovare.

Konteksti i tanishëm i korrupsionit në përgjithësi mund të karakterizohet si rezultante e sistemit politik dhe shoqëror para shpërbërjes së Jugosllavisë së dikurshme, në veçanti të rrethanave para luftës të vitit 1999, dhe të rrjedhave të përgjithshme pas vendosjes së administrimit të përkohshëm ndërkombëtar në Kosovë. Duke mos qenë trajtuar në mënyrë të barabartë me popujt tjerë në Jugosllavinë e dikurshme, popullata shqiptare në masë të madhe ka qenë e detyruar që kërkesat ose të drejtat e tyre t'i realizojë me anë të korruptimit të zyrtarëve të gati të gjitha niveleve. "Të kuptuarit" e tillë me qëllim të realizimit të të drejtave qytetare ka për pasojë vazhdimin e "ushtrimit" të praktikave të tilla edhe pas luftës së vitit 1999. Pas përfundimit ë luftës, ndërtimi i sistemit të ri politik dhe ekonomik, i përcjellë me vështirësitë e shumta të një shoqërie të dëmtuar rëndë nga lufta dhe me ekzistimin e dualizmit pushtetar ndërmjet institucioneve ndërkombëtare dhe atyre vendëse kanë krijuar mjedis të përshtatshëm për korrupsion në të gjitha nivelet institucionale dhe joinstitucionale.

Nuk duhet lënë anash as ndikimin e dimensionit rajonal të korrupsionit, pasi që Kosova rrethohet me një mjedis të karakterizuar me shkallë të lartë të korrupsionit. Kjo për arsye se gati të gjitha shtetet përreth Kosovës kanë kaluar nëpër vështirësitë e tranzicionit, të favorshme për shkallë të lartë të korrupsionit, të cilat kanë qenë posaçërisht të theksuara në Kosovë – shiko kornizën 1.

Korniza 1. Karakteristikat e përbashkëta për vendet me shkallë të lartë të korrupsionit

Sipas Transparency International (TI), vendet në zhvillim dhe pjesa më e madhe e Ballkanit karakterizohen me shkallë të lartë të korrupsionit. Në këtë kuptim Kosova nuk bën përjashtim. Rrethanat dhe proceset aktuale në Kosovë, të karakterizuara me vështirësitë socio-ekonomike të tranzicionit dhe pasojat e konfliktit të armatosur, bëjnë që kushtet për korrupsion në Kosovë të jenë të favorshme.

Karakteristikat e përbashkëta ... për vendet më shkallë të lartë të korrupsionit:

- Shumica e këtyre shoqërive e kanë përjetuar totalitarizmin në të kaluarën dhe/ ose kanë pasur konflikte civile.
- Edhe pse shumica kanë qeveri të zgjedhura dhe karakterizohen si vende demokratike, institucionet e tyre demokratike janë në shkallë të ndryshme të zhvillimit.
- Papunësia është e lartë, kurse shteti tenton ta zvogëlojë papunësinë duke hapur vende të reja të punës në sektorët e shërbimeve/ sektorët publikë.
- Të punësuarit në këta sektorë kanë paga të vogla dhe, varësisht nga madhësia e familjeve të tyre, shumica e tyre mund të konsiderohet se jetojnë nën ose në kufirin e varfërisë.
- Shoqëria civile dhe mediat janë të pazhvilluara ose të dobëta.

Këto karakteristika nuk kanë ndryshuar pothuajse fare gjatë dy-tri viteve të fundit, kështu që rrethanat për rritje të mëtejmë të korrupsionit në Kosovë ekzistojnë ende. Për këtë arsye, IPVQ-të duhen punuar intensivisht në eliminimin e rrethanave që mundësojnë korrupsionin.

Burimi: Raporti i Pralajmërimit të Hershëm #10, Riinvest, 2005.

Korniza 2. Përkufizimet e korrupsionit

Përkufizimi më gjerësisht i cituar i korrupsionit është si "abuzim i detyrës për përftime personale".

Sipas Ligjit Kundër Korrupsionit të Kosovës korrupsioni "nënkupton çdo shkelje të detyrës së personave zyrtarë ose përgjegjës në subjektet juridike dhe çdo veprimtari e iniciatorëve apo përfituesve të kësaj sjelljeje, e drejtuar si përgjigje ndaj një shërbimi që drejtpërdrejt ose indirekt është premtuar,ofruar, dhënë, kërkuar, pranuar apo është pritur për t'u marrë për veten apo për një person tjetër. "

2. Dimensioni i korrupsionit në Kosovë

Gjendja aktuale e dimensionit të korrupsionit në Kosovë nuk është e evidencuar në nivelin i cili do të sugjeronte më me saktësi sferat prioritare në të cilat do duhej përqendruar strategjinë afatshkurtër dhe afatmesme kundër korrupsionit.

Në përgjithësi mungojnë të dhënat mbi cilat do të vlerësohej vëllimi dhe intensitetit ikorrupsionit në Kosovë.

Deri në fillim të vitit 2004 , numri i tërësishëm i hetimeve penale mbi korrupsionin/ mashtrimet/ kriminalitetin financiar ka qenë ndërmjet 10 dhe 15 raste në vit. Gjatë vitit 2005 në gjykata janë trajtuar vetëm 15 raste korrupsioni. Kjo e dhënë më tepër duhet kuptuar si indikacion për mungesën në sferën e hetimeve dhe zbulimeve institucionale sesa si indikator i dimensionit të vërtetë të korrupsionit.

Më tepër informata lidhur me strukturën, shkallën dhe shtrirjen e korrupsionit në Kosovë ofrojnë sondazhet të cilat deri tani janë realizuar e që në tërësi ose pjesërisht kanë pasur për qëllim hulumtimin e percepcioneve të respondentëve të kategorive të ndryshme mbi korrupsionin në Kosovë.[3]

Në vijim do të jepen disa nga karakteristikat themelore të korrupsionit në Kosovë që dalin nga sondazhet e gjertanishme të opinionit.

Të kuptuarit e korrupsionit

Suksesshmëria e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit varet në masë të madhe nga të kuptuarit e korrupsionit nga publiku dhe gatishmëria e tij për të marrë pjesë në këto aktivitete. Popujt e ndryshëm kanë botëkuptime të ndryshme lidhur me dukurinë e korrupsionit, siç ekzistojnë edhe përkufizime të ndryshme të kësaj dukurie (shiko kornizën 2).

Përkundër rëndësisë që ka të kuptuarit e korrupsionit nga publiku, më hollësisht ajo është hulumtuar vetëm në vitin 2004 në kuadër të një hulumtimi të ndërmarrë nga UNDP.[4] Rezultatet e sondazhit përkatës janë paraqitur në tabelën 1.

Tabela 1. Opinionet e respondentëve lidhur me atë se çka përbën korrupsionin

Action	Yes (%)	No (%)
Ofrimi i parave policit me qëllim të parandalimit të marrjes së patent shoferitr	89	9
Pranimi i parave nga ana e zyrtarëve me qëllim të fshehjes apo zvogëlimit të tatimit	85	8
Ushtrimi i presionit në votues gjatë periudhës zgjedhore, qoftë nëpërmjet kërcënimit fizik ose ofrimit të dhuratave në shkëmbim me votën	85	8
Dhënia e parave shtesë për avokatët të cilët ndihmojnë të dyshuarin për të ndërprerë rastin e tij	82	11
Dhënia e parave ose kryerja e ndonjë shërbimi për zyrtarët publik, për "ta shpejtuar procesin"	81	15
Shfrytëzimi i postit zyrtar për zhvillimin e biznesit privat	78	11
Dhënia e informatave të cilat nuk janë për opinion të gjerë për qëllime të përfitimit personal	71	14
Intervenimi tek zyrtari i lartë ekzekutiv për punësimin e të afërmit/ afërmes	68	29
Ofrimi i dhuratës për mjekun që të ketë kujdes të veçantë për ata	64	35
Bërja e ofertës për zyrtarin komunal me qëllim të marrjes së lejes së ndërtimit	57	34
Ofrimi i shërbimit për të marrë leje për pushime	57	35

Burimi: Luftimi i korrupsionit në Kosovë, UNDP, 2004.

1 Qeveria e Kosovës, *Strategjia kundër korrupsionit në Kosovë*, 2004.

2 10 raste janë zgjidhur, 15 raste kanë mbetur të pazgjidhura, kurse 10 raste kanë qenë bartur nga vitit 2004; *Koha Ditore*, 15 mars 2006.

3 Në Kosovë janë bërë disa hulumtime të opinionit: Corruption in Kosovo - Observations and Implications for USAID (MIS, 2003); Corruption and its impact on Kosova economy (Riinvest, 2003); Luftimi i korrupsionit në Kosovë (UNDP, 2004); Mozaiku i Kosovës - Perceptimi i qeverisë komunale dhe shërbimeve publike në Kosovë (UNDP, 2003); Early Warning Reports (Riinvest, 2002-2005); IFES: Vlerësimi dhe përmirësimi i njohurisë së qytetarëve mbi sistemin juridik – Hulumtimi i opinionit publik në Kosovë 2005 (USAID, 2006).

4 Luftimi i korrupsionit në Kosovë, UNDP, 2004.

Ndonëse publiku në përgjithësi ka sens për të dalluar korrupsionin si kuptim, megjithatë është brengosëse e dhëna se gati çdo i dhjeti i anketuar nuk e konsideron asnjërin nga veprimet të prezantuara në tabelën 1 si akt (veprim) korruptiv! Posaçërisht bie në sy e dhëna se respondentët në përqindje mjaft të madhe nuk i konsiderojnë si korruptive intervenimet për punësim të të afërmve të tyre, ofrimin e dhuratës për mjekun për një kujdes të veçantë, si dhe ofrimin e ofertës për marrje të lejes së ndërtimit.

Të dhënat nga tabela 1 indicojnë se shoqëria kosovare është e prirë të jetë mjaft tolerante ndaj dukurisë së korrupsionit. Një konstatim i tillë konfirmohet edhe nga të dhënat mbi indeksin e korrupsionit për Kosovën dhe për disa vende tjera ballkanike, të dhëna këto të paraqitura në tabelën 2. Nga kjo tabelë shihet se vetëm në Shqipëri dhe Maqedoni toleranca ndaj korrupsionit është më e theksuar se në Kosovë.

Tabela 2. Vlerat e indeksit të korrupsionit për disa shtete ballkanike*

	Toleranca e shoqërisë ndaj korrupsionit	Prirja për kompromis ndaj korrupsionit	Presioni i shërbyesve civilë për korrupsion	Përfshirja personale në sjelljet korruptive	Shtrirja e korrupsionit	Vlerësimi i efikasitetit praktik të korrupsionit	Pritjet për ballafaqim me korrupsionin
Shqipëria	2.4	4.5	3.4	2.0	7.0	6.6	5.5
Bosnja dhe Hercegovina	2.0	2.9	2.5	1.5	6.0	5.9	5.0
Bullgaria	1.3	2.7	1.0	0.3	6.4	6.9	5.8
Maqedonia	2.4	3.0	2.3	1.6	6.8	6.1	6.1
Rumania	1.9	3.7	1.9	1.1	6.9	7.1	6.2
Kroacia	2.2	2.6	1.4	0.6	5.3	5.8	4.8
Serbia	2.0	2.7	2.2	1.4	6.0	6.5	5.1
Mali i Zi	1.5	2.6	1.8	1.0	6.0	6.7	4.5
Kosova	2.1	2.8	1.1	0.7	4.9	3.9	3.8

Burimi: MSI Corruption Survey, May 2003, and SELDI Corruption Index Report, April 2002

* *Indekset e korrupsionit janë me vlerë prej 0 deri në 10. Sa më afër vlerës 10 që të jetë indeksi i korrupsionit situata me korrupsion është më e keqe; sa më afër vlerës 0 që të jetë indeksi aq më e mirë është prognoza.*

Korrupsioni i perceptuar si problem shoqëror

Disa nga sondazhet e opinionit, të realizuara deri tani, tregojnë se opinioni kosovar e percepton korrupsionin si problem të rëndësishëm shoqëror. Në vijim janë dhënë disa nga këto perceptime.

Në pyetjen "cilët janë tri problemet kryesore me të cilat ballafaqohet Kosova?", respondentët e sondazhit të realizuar në vitin 2003 në kuadër të një programi të USAID-it e kanë identifikuar pa mëdyshje papunësinë si problemin më të madh (85,8% të respondentëve). Korrupsioni është ranguar në pozitën e dytë sipas rëndësisë së problemit (38,9%), para varfërisë (32,9%), të ardhurave të ulëta (30,9%) dhe çmimeve të larta (30,3%).[5]

Në dhjetor të vitit 2005, në mesin e 18 opsioneve të ofruara në kuadër të Raporteve të Paralajmërimit të Hershëm (RPH),[6] në pyetjen mbi problemet më të mëdha me të cilët

[5] MSI Corruption Survey, USAID, 2003.

[6] Early Warning Report #12, Riinvest, 2005

ballafaqohet Kosova, respondentët shqiptarë e radhisin korrupsionin në pozicionin e katërt (6,3%), pas papunësisë (30,7%), statusit të Kosovës (29,3%) dhe varfërisë (15,6%); respondentët serbë nuk e shohin fare si problem, kurse respondentët e minoriteteve joserbe e radhisin në pozicionin e gjashtë (2,1%) – shiko tabelën 3. Në kuadër të një hulumtimi tjetër të opinionit të realizuar nga UNDP-ja,[7] respondentët e kanë radhitur korrupsionin në pozitën e gjashtë ndër problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet Kosova, shumë më afër me rangimin që është konstatuar në kuadër të RPH-ve.

Tabela 3. Opinionet mbi problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet Kosova (%)

	Shqiptarët	Serbët	Tjerët
Infrastruktura (rrugët)	1.4	1.9	1.4
Furnizimi me energji elektrike	5.0	0.5	2.8
Problemet urbane (ndërtimi i egër)	0.5	0.5	0.7
Mjedisi	0.3	0.0	0.0
Varfëria	15.6	4.8	14.9
Çmimet	0.8	0.0	0.7
Shërbimet shëndetësore	0.3	0.5	1.4
Siguria publike dhe personale	0.2	62.8	0.7
Arsimi	1.1	0.0	1.4
Marrëdhëniet ndëretnike	0.2	9.2	3.5
Papunësia	30.7	8.2	52.5
Pasiguria rreth statusit final të Kosovës	29.3	7.2	14.9
Problemet sociale	2.6	0.0	0.7
Fati i të zhdukurve	2.3	1.0	0.7
Krimi i organizuar	0.8	2.4	0.7
Vrasjet e pazgjidhura	2.2	0.0	0.0
Korrupsioni	6.3	0.0	2.1
Sjelljet asociale (prostitucioni, droga)	0.2	0.0	0.0
Diçka tjetër	0.1	1.0	0.7
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Burimi: Raporti i Paralajmërimit të Hershëm #12, Riinvest, 2005

Meqë RPH-të janë hartuar me një rritëm gati konstant kohor që nga viti 2002, nga të dhënat përkatëse mund të shihet edhe si ka ndryshuar me kohë percepcioni i respondentëve mbi korrupsionin si njërin ndër problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet Kosova. Në figurën 2 janë paraqitur rezultatet përkatëse të sondazheve me respondentët shqiptarë, gjatë periudhës gusht 2004 – dhjetor 2005. Nga kjo figurë shihet se pjesëmarrja e përqindjes së respondentëve shqiptarë të cilët e perceptojnë korrupsionin si njërin ndër problemet me të mëdha ka shënuar rritje gjatë tërë vitit 2005.

[7] Luftimi i korrupsionit në Kosovë, UNDP, 2004.



Figura 1. Pjesëmarrja e korrupsionit ndër problemet më të mëdha me të mëdha të Kosovës
Burimi: Raportet e paralajmërimit të Hershëm, Riinvest, gusht 2004 – dhjetor 2005.

Dimensioni i problemit të korrupsionit ndaj vendeve tjera të Ballkanit

Ndonëse problemi i korrupsionit konsiderohet si njëri ndër problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen vendet e Ballkanit, intensiteti i perceptimit të respondentëve të këtij problemi ndaj problemeve tjera dallon prej vendi në vend. Sipas një sondazhi të opinionit të ndërmarrë në vitin 2002 nga SELDI në tetë vende të Ballkanit (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Maqedoni, Rumani, Kroaci, Serbi dhe Mal të Zi), korrupsioni dominon si problem në Shqipëri (69,4%), Rumani (56,9%) dhe Bosnje dhe Hercegovinë (48.3,%)[8]. Duhet theksuar se problemi i papunësisë dominon në shumicën e këtyre vendeve, dhe se edhe stabiliteti politik është problem i madh për këto vende, përveç Bullgarisë, Rumanisë dhe Kroacisë. Duhet vërejtur po ashtu se problemet ndëretnike janë të theksuara në masë të madhe vetëm në Maqedoni.

Të dhënat për Kosovën në dispozicion lidhur me këtë çështje nuk janë tërësisht të krahasueshme me ato të SELDI-t, pasi që numri i opsioneve të ofruara nuk ka qenë i njëjtë, kurse disa pyetje ndonëse mjaft të afërta për kah domethënia kanë pasur formulim të ndryshëm.[9] Megjithatë, për qëllim krahasimi, nga sondazhet e SELDI-t dhe të RPH #12 janë marrë opsionet e njëjta dhe janë sjellë në emërues të përbashkët krahasues (tërësia e opsioneve 100%). Rezultati i këtij krahasimi është paraqitur në figurën 2, ku për vendet e Ballkanit të sipërpërmendura është marrë vlera mesatare e tyre. Nga figura shihet se derisa në vendet e Ballkanit korrupsioni rangohet diku në pozicionin e dytë për nga pesha, në kuadër të opsioneve të krahasueshme në Kosovë korrupsioni rangohet në pozicionin e katërt. Kjo për arsye se papunësia, stabiliteti politik dhe varfëria konsiderohen si probleme më të mëdha sesa korrupsioni, përkatësisht ato konsiderohen më dominuese.

---

8 Corruption Index Report, SELDI, 2002.

9 Në pyetësorin e SELDI-t si opsion i problemeve më të mëdha me të cilat ballafaqohet vendi është ofruar 'stabiliteti politik', kurse në pyetësorët e RPH-ve që kanë pas të bëjnë më të njëjtën dukuri për Kosovën figuron 'pasiguria rreth statusit final të Kosovës'.



Figure 2. Greatest problems that Kosovo and other Balkan countries are faced with
Source: Corruption Index Report, SELDI, 2002; EWR #12, Riinvest 2005

Shtrirja e korrupsionit në subjektet dhe institucionet publike

Ndonëse percepcionet e publikut mbi korrupsionin në subjektet e ndryshme janë hulumtuar më së shumti, ende nuk ekziston ndonjë formë e standardizuar e hulumtimit për të konstatuar në mënyrë më koherente këto percepcione.

Sipas sondazhit të MIS-it, Korporata Energjetike e Kosovës perceptohet si ndërmarrja më e korruptuar publike në Kosovë (rreth 78%).[10] Ndër ndërmarrjet publike edhe Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës konsiderohet si shumë e korruptuar (55,2%). Percepcionet mbi korrupsionin në subjektet tjera janë gjithashtu të larta sipas këtij sondazhi – shiko tabelën 4. Siç shihet nga kjo tabelë, respondentët i konsiderojnë bartësit e bizneseve, avokatët dhe liderët e partive politike si mjaft shumë të korruptuar.

Tabela 4. Perceptimet e korrupsionet në subjektet dhe institucionet e ndryshme	
KEK	78.2
Bartësit e biznesit	57.0
PTK	55.2
Shërbimi doganor	54.9
Spitalet	45.6
Avokatet	43.3
Liderët e partive politike	33.7
Zyrat e tatimit	31.8
Administrata e UNMIK-ut	31.0
Qeveria lokale	28.2
Gjyqësia	27.7
Prokurorët	25.2
Policia e UNMIK-ut	24.5
Universiteti/ shkollat	23.0
Local Administrata lokale	22.6

Burimi: MSI Corruption Survey, USAID, 2003

[10] MSI Corruption Survey, USAID, 2003.

Një pjesë e madhe e këtyre institucioneve perceptohen si shumë të korruptuara edhe nga ana e komunitetit të biznesit. Sipas hulumtimeve të realizuara në vitin 2006 me komunitetin e biznesit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ndër tetë opsionet e ofruara si "shumë të korruptuara" janë identifikuar AKM-ja (64%), UNMIK-u (49%), dogana (48%) dhe organizatat ndërkombëtare (40%). Mirëpo, si "shumë të korruptuara" konsiderohen edhe gjyqet (38%) dhe shëndetësia (38%).[11]

Të pakta janë sondazhet të cilat kanë regjistruar në mënyrë sistematike opinionin e publikut mbi korrupsionin në Kosovë brenda intervaleve të caktuara të një periudhe më të gjatë kohore, në mënyrë që të detektohet ndryshimi i percepcionit të publikut ndaj kësaj dukurie në institucionet e ndryshme, si dhe vetë ndryshimi i shkallës së korrupsionit në përgjithësi. Lëvizjet e tilla kohore mund të përcjellen vetëm nga sondazhet e realizuara në kuadër të Raporteve të Paralajmërimit të Hershëm (RPH) dhe hulumtimeve të Riinvestit të NVM-ve.

Ndryshimi i percepcionit të korrupsionit nga ana e publikut mund të vërehet nga tabela 5, ku janë paraqitur rezultatet e sondazheve të realizuara në nëntor 2004 dhe dhjetor 2005 në kuadër të RPH-ve. Të dhënat mbi percepcionin janë paraqitur sipas përkatësisë etnike të respondentëve. Siç shihet nga kjo tabelë, KEK-u, AKM-ja, PTK-ja dhe shëndetësia perceptohen nga respondentët shqiptarë si më të korruptuarat si në sondazhin e nëntorit 2004 po ashtu edhe në të dhjetorit 2005. I vetmi ndryshim është se në sondazhin e dhjetorit 2005 dogana është ranguar në pozitën e pestë dhe organizatat ndërkombëtare në pozitën e gjashtë, kurse në nëntor 2005 organizatat ndërkombëtare rangohen në pozitën e pestë, kurse dogana në pozitën e gjashtë. Si edhe në shumë pikëpamje tjera, edhe lidhur me praninë e korrupsionit në institucionet e ndryshme ekziston dallim ndërmjet respondentëve shqiptarë dhe atyre serbë – shiko tabelën 5. Dallimi ndërmjet respondentëve shqiptarë dhe të minoriteteve joserbe është më pak i shprehur.

Tabela 5. Opinionet e respondentëve mbi praninë e korrupsionit në institucionet e ndryshme - korrupsioni i pranishëm "në shkallë të lartë" (%)

	Nëntor 2004			Nëntor 2005		
	Shqiptarët	Serbët	Tjerët	Shqiptarët	Serbët	Tjerët
KEK	64.1 (1)	56.6	41.3	65.5 (1)	60.6	64.0
AKM	55.8 (2)	3.46	19.4	37.9 (2)	63.0	30.1
PTK	42.0 (3)	33.7	8.9	37.7 (3)	54.2	37.0
Shëndetësia	38.0 (4)	10.8	23.0	30.7 (4)	10.7	17.5
Dogana	33.3 (5)	30.7	12.0	23.9	48.6	13.2
Organizatat ndërkombëtare	29.2	42.7	13.1	25.4 (5)	55.4	11.6
Gjyqet	25.3	34.0	5.4	14.0	47.0	7.1
Administrata qendrore	24.1	25.5	5.0	14.4	52.9	5.6
Administrata lokale	21.4	16.1	7.1	11.8	26.3	5.6
Policia e UNMIK-ut	21.8	24.7	7.1	19.9	47.3	3.5
Organizatat joqeveritare	15.7	36.3	5.5	9.5	51.7	12.1
Edukimi	13.8	6.0	5.0	16.7	8.4	6.9
Bankat	13.5	27.0	9.3	7.0	47.4	17.7
ShPK-ja	3.9	41.2	3.8	4.0	51.0	2.2

Burimi: Hulumtimi e opinionit, nëntor 2004 dhe dhjetor 2005, Riinvest

[11] Anketa me 600 NMV, Riinvest 2006.

Percepcionet e publikut lidhur me korrupsionin në institucionet qeverisëse janë të një shkalle mjaft të lartë, ndonëse më të ulët se percepcioni për korrupsionin në institucionet që ofrojnë shërbime publike.

Sipas sondazhit të MIS-it të vitit 2003,[12] rreth 40% të respondentëve besojnë se të gjithë ose gati të gjithë zyrtarët qeveritarë janë të përfshirë në aktivitetet (veprimet) korruptive dhe se rreth 55% të respondentëve po ashtu besojnë se ata (respondentët) duhen ofruar ndonjë favor zyrtarëve publikë për të zgjidhur problemet personale në mënyrë të suksesshme.

Në kuadër të hulumtimit të UNDP-së lidhur me praninë e korrupsionit në institucionet qeverisëse, percepcionet e respondentëve kanë qenë relativisht të larta si për nivelin qendror po ashtu edhe atë lokal të qeverisjes. Sipas këtij hulumtimi,[13] prania e korrupsionit në Qeverinë e Kosovës dhe në Presidencë vlerësohet gati e njëjtë, me ç'rast rreth 42% të anketuarve i konsiderojnë këto institucione si të "korruptuara" dhe 13% si "shumë të korruptuara." Kuvendin e Kosovës e perceptojnë si të "korruptuar" rreth 38% të respondentëve dhe 11% si "shumë të korruptuar". Niveli i perceptuar i korrupsionit në qeverinë lokale është i përafërt me atë të qeverisë qendrore: rreth 48% të respondentëve e konsiderojnë qeverinë e tyre komunale si të "korruptuar", ndërsa 12% e konsiderojnë si "shumë të korruptuar."

Rrethanat që shkojnë në favor të korrupsionit

Disa nga sondazhet e gjertanishme të opinionit i kanë hulumtuar edhe shkaqet përkatësisht rrethanat të cilat favorizojnë korrupsionin në shoqërinë kosovare.

Sipas sondazhit të UNDP-së të vitit 2004,[14] si shkaktar parësorë të korrupsionit të anketuarit kanë identifikuar më së shumti se pagat e ulëta të zyrtarëve në sektorin publik paraqesin shkak parësor të korrupsionit (rreth 63%) – shih figurën 3. Faktorët e tjerët të ofruar si opsione janë identifikuar gati të papërfillshëm: dëshira për pasurim të shpejtë të njerëzve në pozita (10%), kriza morale (7%), mosefikasiteti i sistemit gjyqësor (6%) dhe legjislacionin i pakompletuar (5%).



Figura 3. Shkaktarët (burimet) e korrupsionit

Edhe sondazhi i realizuar nga MIS-i në vitin 2003 e ka anketuar publikun lidhur faktorët që shkojnë në favor të korrupsionit.[15] Edhe sipas këtij sondazhi dominon çështja e pagave të ulëta të zyrtarëve publikë. Gati 91% të respondentëve kanë pohuar se kjo çështje është burim potencial i korrupsionit, kurse për çështjet tjera pohimet e respondentëve kanë qenë më pak të shprehura: mungesa e kontrollit të rreptë administrativ (34%), joefikasiteti i sistemit të gjyqësisë

[12] MSI Corruption Survey, USAID, 2003.

[13] Mozaiku i Kosovës - Perceptimi i qeverisë komunale dhe shërbimeve publike në Kosovë, UNDP, 2003.

[14] Luftimi i korrupsionit në Kosovë, UNDP, 2004.

[15] MSI Corruption Survey, USAID, 2003.

(31%), problemet e shkaktuara nga e kaluara komuniste (30%) dhe motivi i pasurimit të shpejtë (30%). Në formë të ranguar, pagat e ulëta të kuptuara si shkaktar të mundshëm të korrupsionit bëjnë pjesë me rreth 42%.

Pagat e ulëta identifikohen si rrethanë që shkon në favor të korrupsionet edhe në anketat e komunitetit të biznesit. Në tabelën 6 janë prezantuar rezultatet e disa hulumtimeve të realizuara nga Riinvest-i me komunitetin e biznesit në vitet 2003, 2004, 2006. Siç shihet nga kjo tabelë, gjatë gjithë këtyre viteve pagat e ulëta janë identifikuar si shkaktar i mundshëm i korrupsionit (në vitin 2006 rreth 32%). Në vitin 2006 moszbatimi i ligjit është pozicionuar po ashtu shumë lartë (rreth 29%), si dhe mungesa e mekanizmave institucional për ta luftuar korrupsionin (18%).

Tabela 6. Opinionet e komunitetit të biznesit lidhur me burimet (shkaktarët) e korrupsionit*

	2002*	2003	2005
Pagat e ulëta	40.9	43.0	32.2
Mungesa e etikës	9.4	8.1	13.2
Mungesa e mekanizmave institucional	20.0	20.8	17.8
Moszbatimi i ligjit	22.7	20.8	28.7
Diçka tjetër	0.4	0.3	2.0
Pa përgjigje	6.6	1.8	6.1
Gjithsej	100	100	100

Burimi: Anketat me NMV-të, Riinvest, 2003- 2006.

** Analizat e publikimeve të Riinvest-it kanë të bëjnë me të dhënat e të anketuarve të ndërlidhura me afarizmin e NMV-ve për vitin paraprak.*

Në vitin 2005 është realizuar një sondazh për të konstatuar dallimin e opinioneve ndërmjet publikut të gjerë dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatave.[16] Derisa opinioni i publikut të gjerë dhe i shfrytëzuesve të shërbimeve gjyqësore në shumë pikëpamje dallojnë në përqindje relativisht të vogël, dallimet lidhur me burimet e korrupsionit në gjykata janë më të mëdha. Përputhja më e madhe është demonstruar në pikëpamje të pagesave apo dhuratave të bëra nga njerëzit e zakonshëm që të kthejnë rastet në favor tyrin, ku 49% të të dyja kategorive mendojnë se ky faktor paraqet burim korrupsioni – shiko tabelën 7.

Dallimet më të mëdha janë shprehur lidhur me ndikimin e grupeve kriminale, ku për këtë ndikim janë deklaruar 58% të opinionit të gjerë dhe 27% të shfrytëzuesve të shërbimeve në gjykata, dhe ndikimin e qeverisë, ku përqindjet përkatëse kanë qenë 38% dhe 12%.

[16] IFES: Vlerësimi dhe përmirësimi i njohurisë së qytetarëve mbi sistemin juridik – Hulumtimi i opinionit publik në Kosovë 2005, USAID, 2006.

Tabela 7. Opinionet e publikut të gjerë dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatave lidhur me burimet e korrupsionit në sistemin juridik të Kosovës (%)		
	Shfrytëzuesit e shërbimeve	Opinioni i gjerë
Pagesat apo dhuratat e bëra nga njerëzit e zakonshëm që të kthejnë rastet në favor tyrin	49	49
Pagesat apo dhuratat nga avokatët	31	47
Ndikimi i grupeve kriminale	27	58
Ndikimi i partive politike	17	25
Ndikimi i qeverisë	12	38
Ndikimi në baza etnike	6	20
Ndikimi i organizatave ndërkombëtare	4	13
Tjetër	7	1
Nuk e di / refuzon	27	16

Burimi: IFES: Vlerësimi dhe përmirësimi i njohurisë së qytetarëve mbi sistemin juridik – Hulumtimi i opinionit publik në Kosovë 2005, USAID, 2006.

Korrupsioni i perceptuar dhe i përjetuar

Gati në të gjitha hulumtimet e gjertanishme të opinionit të publikut ose komunitetit të biznesit vërehet një dallim i madh ndërmjet shkallës së percepcionit të korrupsionit dhe përvojës vetjake lidhur me korrupsionin. Dallojnë edhe pyetjet të cilat iu janë parashtruar respondentëve, kështu që nuk ekziston ndonjë bazë e mirëfilltë për t'i krahasuar hulumtimet e ndryshme.

Në sondazhin e MIS-it të vitit 2003, të pyetur se a u është kërkuar ndonjë kundërshpërblim për ofrim të shërbimeve, pjesa më e madhe e respondentëve (32,2%) janë deklaruar se nga mjekët iu janë kërkuar pagesa jozyrtare, dhurata ose ndonjë favor.[17] Pas mjekëve janë identifikuar zyrtarët komunalë (16,7%), avokatët (11,2) dhe gjyqtarët (10,5%). Mirëpo, të pyetur se a kanë dhënë ata vetë kundërshpërblime, 3,5% të respondentëve janë deklaruar se u kanë dhënë para të gatshme zyrtarëve publikë, 2,3% kanë dhënë dhurata, kurse 5,3% kanë bërë ndonjë favor tjetër.

Sondazhet e realizuar në kuadër të Sistemit të Paralajmërimi të Hershëm në Kosovë e kanë hulumtuar këtë çështje në dy pikëpamje: kushtëzimit të ofrimit të shërbimeve nga ana e zyrtarëve publikë dhe shkallës së korrupsionit bazuar në përvojën personale të respondentëve. Në tabelat 8 dhe 9 janë paraqitur të dhënat përkatëse për një periudhë njëvjeçare kohore: korrik 2004 – dhjetor 2005.

Tabela 8. Kushtëzimi i ofrimit të shërbimeve nga ana e zyrtarëve publikë me dhënien e ryshfetit, dhuratave ose favoreve tjera (%)			
	Shqiptarët	Serbët	Tjerët
Korrik 2004	8,5	26,5	10,9
Nëntor 2004	11,8	23,7	8,3
Mars 2005	11,0	28,0	-
Qershor 2005	15,7	26,1	11,4
Dhjetor 2005	11,5	-	16.0

Burimi: Sondazhet e Riinvestit, korrik 2004 – dhjetor 2005

[17] MSI Corruption Survey, USAID, 2003.

Tabela 9. Shkalla e korrupsionit bazuar në përvojën personale të respondentëve (%)			
	Shqiptarët	Serbët	Tjerët
Korrik 2004	11,7	21,0	12,1
Nëntor 2004	12,1	14,8	15,0
Mars 2005	15,0	29,6	12,8
Qershor 2005	18,3	25,0	11,1
Dhjetor 2005	14.1	17.1	19.1

Burimi: Sondazhet e Riinvestit, korrik 2004 – dhjetor 2005

Sipas deklarimeve të respondentëve shqiptarë, shkalla e korrupsionit e bazuar në përvojën personale të tyre brenda periudhës mbi njëvjeçare është rritur prej 11,7% në korrik 2004, në 18,3% në qershor 2005 dhe pastaj shënon një rënie në 14,1%. E ngjashme është situata edhe kur bëhet fjalë për kushtëzimin e ofrimit të shërbimeve nga zyrtarët publikë me dhënien e ryshfetit, dhuratave ose favoreve tjera – krahaso tabelat 8 dhe 9.

Edhe sipas sondazhit të UNDP-së, vetëm 15% të anketuarve e bazojnë vlerësimin e tyre për korrupsionin në institucione të ndryshme në përvojën tyre personale, ndërsa qytetarët shumë më tepër janë të prirë t'i krijojnë perceptimet e tyre në bazë të bisedave të tyre me miq dhe të afërm (32%) dhe në bazë të informatave nga mediat (29%).[18] Duhet theksuar se dallimi ndërmjet korrupsionit të perceptuar dhe atij të përjetuar personalisht nuk është i njëjtë për të gjitha institucionet. Në figurën 4 janë ilustruar këto dallime. Janë për t'u veçuar të dhënat mbi përvojën personale të respondentëve lidhur me korrupsionin në spitale dhe qeveritë lokale, në të cilat ata edhe më së shumti frekuentojnë dhe ku janë ballafaquar me më së shumti me korrupsionin në këto institucione.

Sondazhet me komunitetin e biznesit tregojnë se raporti ndërmjet korrupsionit të përjetuar personalisht dhe atij të perceptuar është pothuajse dy herë më i madh sesa te publiku i gjerë. Sipas këtyre sondazheve, në vitin 2003 korrupsioni i përjetuar ka njehsuar 26%, në vitin 2004 rreth 30%, kurse në vitin 2006 mbi 32%.[19] Kjo e dhënë është me rëndësi të veçantë, pasi që korrupsioni në sferën e biznesit pengon zhvillimin ekonomik, e me të edhe zhvillimin e përgjithshëm shoqëror.



Figura 4. Dallimi ndërmjet korrupsionit të perceptuar dhe të përjetuar të respondentëve (%)

[18] Luftimi i korrupsionit në Kosovë, UNDP, 2004.

[19] Anketa me 600 NMV, 2003-2006, Riinvest.

3. Sfidat e korrupsionit

Nga të dhënat sipër të analizuara të sondazheve shihet se të shumta janë çështjet të cilat duhen luftuar në sferën e korrupsionit. Suksesi i luftimit të korrupsionit varet në pjesë të madhe nga vullneti politik dhe nga mekanizmat institucionalë të ndërtuar për këtë qëllim. Në këtë kuptim, nuk mund të thuhet se në Kosovë mungon as vullneti politik e as një pjesë e mekanizmave kundër korrupsionit, sidomos të artikuluar dhe ndërtuar gjatë dhe pas vitit 2004. Deri tani janë ndërmarrë hapat vijues në ndërtimin e infrastrukturës ligjore dhe institucionale nga lëmi i luftimit të korrupsionit:

- Në dhjetor 2003 është formuar Grupi Punues Ndërministror Kundër Korrupsionit;
- Në mars 2004 është aprovuar Strategjia Kundër Korrupsionit në Kosovë;
- Në maj 2005 Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin Kundër Korrupsionit, i cili është nënshkruar edhe nga PSSP-ja;
- Në fillim të vitit 2006 është aprovuar Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit;
- Janë miratuar një sërë ligjesh të ndërlidhura me luftimin korrupsionit;
- Në prill 2006 është konstituuar Këshilli i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejmë Agjencia), kurse në korrik 2006 është zgjedhur Drejtori i Agjencisë.

Përveç këtyre, në funksion të luftimit të korrupsionit janë edhe Zyra e Revizorit të Përgjithshëm dhe Zyra e Ombudspersonit si subjekte mbikëqyrëse.

Në këtë pikëpamje mund të thuhet se janë bërë hapa të rëndësishëm, mirëpo kuadri ligjor duhet kompletuar dhe duhet amenduar aty ku tanimë janë vërejtur dobësitë e tyre.

Koncepti i tanishëm i luftimit të korrupsionit në Kosovë paraqet një model të politikës preventive, ku supozohet që edhe vetë institucionet e ndryshme në nivel qendror ose lokal, si dhe vetë shoqëria civile në kuptim të gjerë duhen luftuar korrupsionin në pajtim me infrastrukturën ekzistuese ligjore. Një pjesë e madhe e aktiviteteve të cilat duhen ndërmarrë në këtë drejtim janë specifikuar në Planin e Veprimit Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejmë Plani). Në këtë plan të veprimit janë veçuar disa dhjetëra masa të ndryshme të cilat duhen përmbushur brenda periudhës 2006-2007, si dhe janë identifikuar aktorët të cilët duhen përmbushur planin. Plani përmban:

- Masat specifike antikorrupsion;
- Masat legjislative antikorrupsion;
- Masat gjyqësore dhe zbatimi i ligjit;
- Masat e reformimit të administratës publike;
- Masat në fushën e financave publike dhe ekonomisë;
- Mediat, shoqëria civile dhe pjesëmarrja e publikut;
- Masat në ngritjen e kapaciteteve dhe edukim;
- Masat e tjera të reformës institucionale.

Siç shihet, Plani është me karakter preventiv dhe i mbulon gati të gjitha sferat ku duhet parandaluar korrupsionin. Mirëpo, në rrethanat e tanishme të zhvillimit shoqëror dhe institucional në Kosovë, një pjesë e madhe është duke shënuar ngecje të konsiderueshme kohore në zbatim. Kështu, vetë konstituivi i Këshillit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, subjektit

qenësor për luftimin e korrupsionit, ka shënuar vonesë prej rreth gjashtë muajve, kurse i drejtorit të Agjencisë edhe një muaj më shumë. Krahas kësaj duhet shtuar se Agjencia ende nuk është pajisur as me lokalet ku duhet ta ushtrojë veprimtarinë dhe as që i janë alokuar mjetet financiare të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të saj. Marrë parasysh edhe faktin se gati asnjëra ministri nuk i ka përmbushur as gjysmën e masave të parashtruara me Plan, është e qartë se parandalimi/ luftimi i korrupsionit në Kosovë ende gjendet para sfidave të mëdha.

Korniza 4. Fushëveprimi i Institutit "RIINVEST"

IInstituti për Hulumtime Zhvillimore "RIINVEST" është organizatë hulumtuese private joprofitabile e cila veprimtarinë e vet e ushtron që nga viti 1995. Misioni i saj është që të promovojë zhvillimin modern ekonomik të Kosovës mbi bazën e filozofisë së ndërmarrësisë. Si institut i parë hulumtues "think tank" në Kosovë RIINVEST-i ka krijuar një pozitë të fortë, partneritet dhe aleanca me segmente të ndryshme të shoqërisë në Kosovë si dhe me partnerë dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare. Aktivitetet hulumtuese dhe shërbimet tjera të RIINVEST-it janë të bazuara në standarde ndërkombëtare.

Numri i të punësuarve është rritur nga 5, sa kishte në fillim, në 29 të punësuar. Deri tani 15 hulumtues të rinj janë mbështetur në studime të magjistraturës dhe doktoratës në universitete në Britani të madhe, Suedi dhe Gjermani.

Aktivitetet kërkimore: 45 raporte studimore për aspekte të ndryshme të zhvillimit dhe politikave ekonomike; 30 hulumtime dhe anketa në terren me mbi 26.000 respondentë dhe 6 raporte vjetore të zhvillimit të NVM-ve; 17 strategji komunale të zhvillimit ekonomik lokal.

Konferenca dhe tubime: 6 konferenca ndërkombëtare, 24 seanca të Forumit ndërkombëtar dhe Tryezës së RIINVEST-it me rreth 2.900 pjesëmarrës.

Aktivitete të edukimit: 8 shkolla verore me 200 pjesëmarrës, 24 workshop-e dhe seminare trajnimi me rreth 2.900 pjesëmarrës.

Aktivitete tjera: 12 plane biznesi dhe studime të fizibilitetit për kompani kosovare dhe të jashtme.

Publikime: 57 raporte dhe publikime tjera në shqip dhe 37 në anglisht me një tirazh prej 28.450 kopjesh.

Luftimi i korrupsionit në Kosovë

Fron Nahzi, Instituti i menaxhimit East West, Inc.

Deri në fund të këtij viti, Kosova pritet të bëhet shtet i pavarur. Sikur shumë shtete të reja të pavarura të rajonit, Kosova do të përballet me pjesën e vet të sfidave gjatë krijimit të një shteti i të shëndoshë nga aspekti juridik si dhe fiskal. Një vend pa dalje në det dhe i vendosur në një nga rajonet më të pazhvilluara të Evropës, Kosova do të konkurrojë për investimet tepër të nevojshme si dhe ndihmën ndërkombëtare. Duke pasur parasysh këtë garë, Kosova nuk mund t'ia lejojë vetës që t'i bëjë gabimet e fqinjëve, gjegjësisht të ketë korrupsion në qeverisje, mungesë të kompetencës si dhe tolerancës.

Gjatë dekadës së fundit të investimeve të perëndimit në zhvillimet ekonomike, politike, dhe ushtarake në Ballkanin Jugor, bashkësia ndërkombëtare dhe udhëheqësit lokalë e kanë vënë në theks stabilitetin e rajonit, por nuk i kanë trajtuar disa prej problemeve specifike dhe de-stabilizuese me të cilat ballafaqohet rajoni, përfshirë këtu edhe korrupsionin. Shkalla e lartë e papunësisë e kombinuar me korrupsionin, ka krijuar vend të përshtatshëm rekrutues si për grupet militare ashtu edhe të krimit të organizuar. Shumë njerëz nuk mund të mbijetojnë ekonomikisht pa lidhjet e tyre me krimin e organizuar. Me fare pak gjasa për punësim ose tregje në dispozicion, publiku bëhet peng i bizneseve mafioze me vlerë miliona dollarësh. Gangsterët janë duke e vërtetuar vetveten në rajon ndërsa janë të prirë që ta shtrijnë ndikimin e tyre më tej edhe në Evropën Perëndimore. Shumica e profitit vjen nga trafikimi i mallrave ilegale (drogave, cigareve dhe njerëzve) nëpër vendkalime të sigurta përmes çifligjeve të ndryshme rajonale.

Kosova përballet me shumë prej elementeve të njëjta të korrupsionit të pranishme në shumicën e shoqërive të zhvilluara. Mirëpo, Kosova është më shumë e prirë ndaj korrupsionit për shkak të strukturës së paqartë qeveritare të saj, e komplikuar edhe më tej nga statusi i pazgjidhur i Kosovës. Që nga viti 1999, Kosova mund të përshkruhet si një shtet i pa-shtet që qeveriset nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u), me mandatin e dhënë nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të KB-së. Rezoluta 1244 e autorizon Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP-në) me pushtetin e plotë administrativ, dhe në pajtim me të, PSSP-je i përgjigjet vetëm Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve. Zgjedhjet parlamentare edhe më tej janë çështje të komplikuara: zyrtarët e zgjedhur janë përgjegjës para opinionit publik si dhe para UNMIK-ut, por atyre u mungon pushteti i ligjvënies ashtu siç ekziston në shumicën e sistemeve parlamentare. Rrjedhimisht, zyrtarët e zgjedhur kosovarë, janë ankuar se kalimi i pushtetit ka qenë i ngadaltë, por megjithatë ata nuk kanë arritur t'i trajtojnë çështjet siç janë, mungesa e energjisë elektrike, papunësia (e vlerësuar 55%) si dhe çështjen e ngritjes së shkallës së krimit dhe korrupsionit, veçanërisht trafikimit të narkotikëve, karburanteve, cigareve dhe njerëzve.

Përkundër problemeve të lartpërmendura, janë shënuar edhe disa zhvillime pozitive. Komuniteti i OJQ-ve ka marrë qasje pro-aktive për luftimin e korrupsionit. Në nivelin e komunave, OJQ-të kanë bërë me sukses presion në zyrtarët e tyre të zgjedhur, për të zhvilluar më shumë debate dhe njoftime publike. Në nivelin qendror, OJQ-të kanë udhëhequr fushata të cilat kanë rezultuar në aprovimin e një procesi më transparent buxhetor. Koalicionet e OJQ-ve kanë avokuar në mënyrë të suksesshme për hapjen e komisioneve parlamentare për publikun dhe kanë çuar në miratimin e ligjit mbi lirinë e informatës. Gjersa mediat kanë raportuar në mënyrë aktive për korrupsionin, shumica e gazetarëve, duke u frikuar për reprezalje, nuk kanë përmendur

emra në raportimet e tyre. Por, shumë prej nismave kundër korrupsionit kryesisht janë shuar, pjesërisht për shkak të zhgënjimet në procesin e drejtimit të veçantive të strukturës komplekse dhe unike të qeverisjes në Kosovë, të kombinuar me mungesën e përgjigjes si nga IPVQ-të ashtu edhe UNMIK-u. Apatia ekzistuese si në anën e organeve vendore (IPVQ-ve) dhe organeve ndërkombëtare (UNMIK-u) ndaj përpjekjeve të qytetarëve për llogaridhënie si dhe dështimi për të ndërmarrë masa kundër zyrtarëve të korruptuar ka ulur entuziazmin për luftimin aktiv të korrupsionit në Kosovë.

Prej vitit të kaluar Kosova e ka përshpejtuar procesin e privatizimit dhe janë bartur shumë kompetenca tek IPVQ-të. Ne kemi qenë dështmitarë gjithashtu edhe të shtimit të numrit të akuzave për zyrtarët e korruptuar gjatë dhënies së kontratave dhe licencave, dhe për trafikim të cigareve. Nëse Kosova nuk ndërmerr masa të menjëhershme për luftimin e korrupsionit, atëherë ajo mund të bjerë në të njëjtin pus sikurse shumë prej fqinjëve të saj, ku si pushtet kryesor nuk është më qeveria ose popullit të cilën e përfaqëson por "pushteti i parasë". Njerëzit e pasur janë po ata të cilët e kontrollojnë pushtetin. Për ta parandaluar që Kosova të ketë të njëjtin fat, është e nevojshme të krijohet dhe zbatohet një kornizë e rëndësishme e ligjeve, praktikave, procedurave qeverisëse dhe të kontrollit, së bashku me shoqërinë civile të mobilizuar, sektorin privat dhe mediat masive. Kosova tani e ka rastin të mësojë nga gabimet e fqinjëve dhe të ketë sukses në luftimin e korrupsionit. Shumica e programeve të suksesshme kundër korrupsionit, karakterizohen me këto tre elemente kryesore:

I. iNdjekje efektive dhe dënimi i fenomeneve korruptive
II. Parandalimi, p.sh., miratimi i ligjeve të shëndosha
III. Edukimi shoqëror në kuptimin më të gjerë të fjalës

Më poshtë janë paraqitur lista të shembujve të problemeve më të zakonta dhe të zgjidhjeve më të përshtatshme të cilat mund të bëhen nga sektori privat dhe qeveritar i Kosovës drejt luftimit të korrupsionit në të gjitha nivelet lokale dhe qendrore, sektorin ekonomik, si dhe në nivel të parlamentit[20].

Statusi final i Kosovës pritet të zgjidhet deri në fund të këtij viti. Kjo do të ketë për pasojë një shtim të jashtëzakonshëm të punës dhe përgjegjësive për qeverisjen e Kosovës. Qeveria e re e Kosovë, me detyrë të zbatimit të politikave të cilat burojnë nga marrëveshja e Vjenës dhe të ndërtimit të institucioneve qeveritare, duhet të ndërmarr masa të menjëhershme që të dështmojë se është e zotuar ta luftojë korrupsionin në çdo nivel.

[20] Pjesë nga lista e problemeve dhe zgjidhjeve të zhvilluara nga grupet punuese të konferencës së EWMI/USAID, mars 2002 për luftimin e *korrupsionit në Kosovë: Mësimet nga rajoni.*

Fighting Corruption at the Municipal (Local Government) Level

Problemet	Zgjidhjet
• Mungesë transparence: ➢ Hartimi i buxhetit në mungesë të debatit publik ➢ Mungesa e transparencës gjatë vendim marrjes ➢ Tenderët ➢ Keqinformim i qytetarëve lidhur me pronën komunale dhe rregulloret • Pagat e ulëta • Çështjet e pazgjidhura pronësore ➢ Legalizimi i ndërtimeve pa leje ➢ Prokurimi publik i parregulluar ➢ Mungesa e dokumentacionit dhe planeve urbanistike nëpër komuna • Mungesa e transparencës në punën e komiteteve politike dhe të financave • Lejet e punës të lëshuara nga komuna • Nepotizmi – punësimi i anëtarëve të familjes • Mungesa e ligjeve • Mungesa e monitorimit të pushtetit lokal nga ana e qytetarëve • Ndërgjegjësimi dhe edukimi i qytetarëve lidhur me autorizimet e pushteteve lokale • Angazhimi në aktivitetet me konflikt interesash • Burokracia qeveritare	• Përshtatja e rregullave dhe procedurave të kuvendeve komunale për të lejuar publikun në prokurimin publik • Aprovimi i pjesëmarrjes në planifikimin buxhetor. • Publikimi i buxhetit komunal nëpër media • Miratimi i ligjit kundër korrupsionit dhe përcaktimi i dënimeve kundër individëve të përfshirë në korrupsion. • Përcaktimi përmes aktit të veçantë se çka përbën konflikt të interesave • Përcaktimi i masave kundër zyrtarëve të cilët punësojnë në administratë mbi bazat e familjes ose përkatësisë partiake • Krijimi i komisioneve, jashtë kuvendit komunal për monitorimin e zbatimit të buxhetit • Inkorporimi në kuadër të rregulloreve komunale të kërkesës që anëtarët e komisionit mbikëqyrës për projektet e financuara nga komuna të mos jenë të punësuar të administratës komunale. • Miratimi i rregullores me të cilën ndalohet autoriteti qendror fiskal të punojë në cilësinë e kontabilistit për bizneset private • Të kërkohet që komuna të paraqesë raportet çerek – vjetore mbi shpenzimet • Të ofrohen trajnime anti-korrupsion për administratën • Identifikimi i pronës private karshi asaj shoqërore -shtetëror

Fighting Corruption in Central Government

Problemet	Zgjidhjet
• Mungesa e transparencës	• Miratimi i ligjit mbi lirinë e informimit e cili siguron qasje të publikut në informatat e qeverisë, vendim marrjen në qeveri, përveç kur ka arsye të qarta për mos dhënien e këtyre informatave
• Shpalosja financiare	• Miratimi i ligjit mbi shpalosjen financiare. Të punësuarit e sektorit publik duhet të shpalosin çdo vjet të gjitha interesat e tyre financiare. Kjo zbatohet në udhëheqësit dhe drejtuesit e shërbimeve të udhëhequra nga qeveria si dhe atyre të financuara nga ajo. • Të kryhet regjistrimi (auditimi) i të gjitha ndërmarrjeve shtetërore për të siguruar se ato drejtohen si duhet.
• Ligji mbi prokurimin	• Të ndahet funksioni i rregullimit nga funksioni i aktiviteteve; personi ose organizata përgjegjëse për zbatimin e rregullave të prokurimit nuk duhet të angazhohet në asnjë aktivitet të prokurimit.
• Tenderët	• Komisionet përzgjedhëse në nivelin e veprimit, p.sh., komisionet të cilat momentalisht i përzgjedhin fituesit e tenderëve, duhet të përfaqësohen nga përfaqësues të qeverisë dhe me vëzhgues të pavarur nga OJQ-të, për ta hapur procesin dhe siguruar se i njëjti zhvillohet në mënyrë të ligjshme.
• Agjencitë e pavarura të rregullimit	• Duhet përfshirë disa vëzhgues nga OJQ-të dhe shoqëria civile, për të parë se zbatohen si duhet rregullimet.
• Transparenca	• Të sigurohet qartësi për publikun lidhur me atë se kush është përgjegjës për çka brenda qeverisë qendrore; • Shpërndarja e informatave mbi organizimin dhe aktivitetet e qeverisë qendrore për publikun në mënyrë që ky i fundi të dijë se kujt t'i drejtohet kur e kanë ndonjë problem apo çështje.
• Mungesa e llogaridhënies	• Krijimi i Auditorit të Përgjithshëm dhe krijimi i departamenteve kundër korrupsionit brenda secilës ministri për mbikëqyrjen e saj. Auditori i Përgjithshëm do të jetë i autorizuar t'i mbikëqyrë ministritë dhe qeverinë dhe t'i raportojë drejtpërdrejtë parlamentit. Ministritë, agjencitë, qeveria qendrore duhet të ketë më shumë përgjegjësi raportuese para Auditorit të Përgjithshëm, ndërsa në rastin e prokurimit atëherë para organit përkatës rregullues.

Luftimi i korrupsionit në nivelin e parlamentit

Problemet	Zgjidhjet
• Sjellja e anëtarëve të parlamentit – duhet të jetë mbi baza etike dhe transparente në të gjitha veprimet e tyre.	• Kodi i sjelljes me pushtet ekzekutimi për deputetët, • Krijimi i komisionit për etikë me qëllim të zbatimit • Të kërkohen deklaratat financiare të deputetëve dhe të përfshihen dënimet për ofrimin e informatave të rrejshme në deklaratën financiare
• Konflikti i interesave	• Krijim i rregullave për konflikt të interesave • Caktim i ndalesës së dhuratave – zyrtarët publikë nuk duhet të lejohen të pranojnë dhurata ose nga ta duhet të kërkohet ta bëjnë të ditur këtë informatë për publikun dhe publiku të vendosë
• Korrupsioni në ndërmarrjet publike dhe i zyrtarëve publik	• Rregullat për ndalimin e mitos dhe kodi i sjelljes i zbatueshëm për të gjithë njerëzit të cilët lidhen me agjencitë të cilat marrin paranë publike; nëse dënohet për veprën e mitos, ai person nuk do të lejohet të punojë asnjëherë në organin publik
• Mbikëqyrja e parlamentit, UNMIK-ut dhe pushtetit ekzekutiv	• Koha e pyetjeve- deputetët mund t'i bëjnë pyetje qeverisë; • Komisioni i auditimi me autorizime për marrjen në pyetje të organeve të pushtetit ekzekutiv lidhur me shpenzimet e tyre • Rregullat e mbrojtjes së personave të cilët denoncojnë (raportojnë) korrupsionin dhe të sigurohet se ata nuk do ta humbasin punën e tyre • Legjislacioni "Sunset" – çdo herë pas dy apo tre vjetësh, programe të financuara nga qeveria për analizimin e shërbimeve për të parë se këto programe janë efektive dhe se paratë janë shpenzuar si duhet përmes këtyre programeve.
• Financimi i partive politike	• Krijimi i agjencive të pavarura për rishqyrtimin e veprimeve të partive dhe kandidatëve
• Praktikat ekonomike – kontratat dhe prokurimi	• Kuvendi duhet të ketë udhëzime të qarta lidhur me kontratat dhe prokurimin; mbikëqyrje qeveritare e këtij procesi
• Dokumentacioni i rrejshëm – lejet e ndërtimit, letërnjoftimet, regjistrimi i automjeteve	• Futja në kodin penal; sanksionet penale, gjobave dhe dënimeve; sigurimi i zbatimit rigoroz dhe respektim i këtyre rregullave

• Pastrimi i parave	• Dispozita të fuqishme dhe dënime penale për shkeljet në lidhje me pastrimin e parave
• Monopolet dhe caktimi i çmimeve me marrëveshje	• Aprovimi i legjislacionit adekuat kundër praktikave kundër konkurrencës, caktimit me marrëveshje të çmimeve dhe marrëveshjeve të fshehta; nevojitet funksioni i mbikëqyrjes për monitorimin dhe përcjelljen e këtyre aktiviteteve.

Luftimi i korrupsionit në sektorin ekonomik

Korrupsioni e ngritë nivelin e shpenzimeve për ndërmarrjet, dhe të njëjtën kohë zvogëlon profitin; ky zvogëlimi profitit e zbrit edhe nivelin e motivimit për vazhdimin e biznesit ndërsa në fund edhe mund ta zvogëlojë numrin e stafit dhe mbyllje të plotë të ndërmarrjes.

Problemet	**Zgjidhjet**
• Vonesat në marrjen e lejeve • Raportet me zyrtarët e taksave dhe përfshirja e korrupsionit • Korrupsioni në procesin e tenderimit • Mungesa e planit urbanistik strategjik, që rezulton me paqartësi lidhur me pasurinë dhe lëshimin e lejeve; ata që kërkojnë lejet zakonisht mundohen t'i zgjidhin paqartësitë me sjellje korruptive. • Procesi i privatizimit mund të përcillet me një shkallë të lartë të korrupsionit • Mungesa e qeverisjes efektive në nivel të komunave	• Zbatimi i rregulloreve transparente në procedurën e lëshimit të lejeve, përcaktimi i qartë i afateve, respektimi i afateve dhe dhënia e arsyetimit për rastet e refuzimit të lejeve. • Komuniteti i biznesit, p.sh., sektori privat, duhet t'i denoncojë para organeve qeveritare rastet e korrupsionit; bizneset e përfshira në këtë praktikë mund të paguajnë çmim më të lartë duke iu mohuar qasja në tregje të caktuara • Ngritja e nivelit të informatave dhe cilësisë të ndërmarrjeve korporata duke insistuar në zhvillimin e funksioneve drejtuese brenda këtyre ndërmarrjeve. • Të definohen qartë konceptet e partneritetit dhe konfliktit të interesave. • Të sigurohet respektimi i të drejtave pronësore të aksionarëve, veçanërisht të atyre pakicë, p.sh., të atyre që kanë më pak aksione. • Të zhvillohen instrumente raportuese dhe të brendshme dhe procedura të brendshme të auditimit, si dhe bëhen auditime të jashtme dhe të pavarura. • Të krijohet web-faqja mbi çështjet e korrupsionit. • Të nxitet dialogu midis qeverisë dhe komunitetit të biznesit.

Luftimi i Korrupcionit në Kosovë

Franklin De Vrieze

Kosovo's governing system

Kosova është duke u administruar nën autoritetin civil të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. UNMIK-u është themeluar në qershor të vitit 1999, pas përfundimit të fushatës ushtarake të NATO-s që detyruan tërheqjen e forcave ushtarake, policore dhe paraushtarake nga Kosova.

Pas një periudhe në të cilën UNMIK-u paraqiste autoritetin e vetëm qeverisës në Kosovë, zgjedhjet parlamentare qenë mbajtur në tetor të vitit 2001 dhe një qeveri përfshirëse e mori pushtetin, duke i bashkuar të gjitha partitë më të mëdha politike të shqiptarëve të Kosovës. Bartja e parë e kompetencave nga UNMIK-u në Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) mundësuan krijimin e ministrive kyçe siç janë: e Arsimit, e Ekonomisë dhe Financave, e Energjetikës dhe Minierave, e Tregtisë dhe Industrisë dhe e Shërbimeve Publike. Pas zgjedhjeve të dyta parlamentare në tetor të vitit 2004, pushtetin e mori koalicioni i ri qeverisës, ndërsa opozita e zëshme në Kuvend e vëzhgonte me kujdes performancën e qeverisë. Në mars të vitit 2006, qeverisë iu shtuan ministrat e rinj, ai i Brendshëm dhe ai i Drejtësisë.

Situata politike në Kosovë mbeti stabile në vitin 2005 përderisa i Dërguari i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara (KB-ve) për Standardet, Kai Eide, punonte për ta përfunduar shqyrtimin e tij. Nën udhëheqjen e të Dërguarit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara, Marti Ahtisaari, procesi i përcaktimit të statusit të ardhshëm politik të Kosovë ka filluar në nëntor të vitit 2005, me pritjen që përcaktimi i statusit të Kosovës deri kah fundi i vitit 2006 do të kontribuojë në ringjalljen ekonomike, stabilitetin politik dhe në ngritjen në shkallë më të lartë të llogaridhënies nga IPVQ-të.

Korrupcioni në Kosovë

Mangësitë substanciale demokratike dhe burokratike e pengojnë performancën e IPVQ-ve. Ekzistimi i korrupcionit ka qenë çështje shqetësuese për njëfarë kohe. Në vitin 2003, në një raport të autorizuar nga USAID-i thuhej:*"Megjithëse në opinionin publik dhe në diskutimet në mas media presupozohen nivele të larta të korrupcionit publik, nuk duket se korrupcioni është forcë që ka depërtuar në procesin e qeverisjes dhe nuk duket që e minon në mënyrë të konsiderueshme kapacitetin e qeverisë në kryerjen e detyrave të veta për të ofruar shërbime në mënyrë domethënëse."* Sidoqoftë, anketa saktësonte se opinioni publik kosovar i përceptonte si organet më të korruptuara: KEK-un (ndërmarrjen e energjisë elektrike), komunitetin e biznesit, PTK-në (postën dhe telekomunikacionin), doganat, spitalet dhe juristët. Popullata serbe mendon se shumë insitutucione të Kosovës janë më të korruptuarat se sa popullata shqiptare dhe komunitetet e tjera. Një qasje optimiste mbetet evidente në vitin 2003, siç sugjerohej nga autorët e raportit të njëjtë:*"Korrupcioni nuk duket të jetë i përhapur aq gjërësisht në mesin e zyrtarëve publikë, kërkesat e zyrtarëve të korruptuar janë më të ulëta dhe shkalla e përfshirjes së qytetarëve në transaksione të korrupcionit është më e ulët në Kosovë se në vendet e tjera të Evropës Juglindore."* Sidoqoftë, është bërë një paralajmërim i qartë se problemet me korrupcionin mund të intensifikohen pasi që më shumë kompetenca po barten në Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë nga UNMIK-u. Nga ana tjetër, po ashtu, është vënë

në dukje se administrata e UNMIK-ut ka qenë një rol model i dobët kur flasim për transparencën dhe llogaridhënien.

Tri vite më vonë, në janar të vitit 2006, në analizat e kohëve të fundit mbi klimën e investimeve në Kosovë, Departamenti i Shtetit i SHBA-ve tingëllon më pak optimist dhe ka vlerësuar se korrupcioni duket të jetë i përhapur gjërësisht dhe se ka mungesë të veprimit koheziv dhe të fuqishëm kundër tij, megjithëse qeveria e Kosovës kishte lansuar një fushatë anti-korrupcion në gusht të vitit 2005. Aty thuhet: *"Korrupcioni në Kosovë është i përhapur gjërësisht në të gjitha nivelet në mbarë qeverinë dhe në industrinë private, dhe në mënyrë të pavolitshme ka efekt në zhvillimin ekonomik. Ka raporte të shpeshta lidhur me parregullsitë në procedurat e tenderimit publik. Evazioni fiskal është i lartë dhe shumë biznese vendore dhe të huaja janë thellësisht të shqetësuara sa i përket etikës profesionale të zyrtarëve qeveritarë, të cilët siç pohohet marrin mito ose i zhvasin firmat në këmbim të licencave, lejeve, lëvizjes së dokumentave ose shërbimeve publike rutinore. Praktikat tradicionale të dhënies së huave dhe të biznesit kanë prirje t'i favorizojnë lidhjet dhe nepotizmin sa i përket kredidhënies. Përflitet me të madhe reketimi i motivuar politikisht."* Në raportin e tij mbi transicionin në Kosovë, Grupi Ndërkombëtar i Krizave vë theksin në "*kumbarllëkun i cili duket se favorizon zgjedhjen e kandidatëve nga qeveria nëpër bordet e reja të shërbimeve publike dhe të organeve rregullatore."*

Brenda disa viteve të ardhshme, shoqëria Kosovare do të ballafaqohet me zgjedhjen që ta vëjë nën kontroll korrupcionin, ose ai do të jetë aq i rrënjosurs saqë do të jetë i pamundur të trajtohet. Gjatë vitit të fundit, është vërejtur një vullnet substancial politik në IPVQ për t'u marrë me problemin e korrupcionit para se të dalë jashtë kontrollit. Anketa anti-korrupcion e UNDP-së në Kosovë, e bazuar në Indeksin e Përceptimeve të Korrupcionit të Transparency International, jep një vështrim të vetëdijes së popullatës lidhur me korrupcionin, efektit të tij negativ në ekonomi dhe në jetën politike, si dhe në përkrahjen e popullatës për ta luftuar atë. Po ashtu, mediat Kosovare dhe shoqëria civile janë bërë më këmbëngulëse për t'u marrë me këtë çështje, duke zbardhur praktika të caktuara të korrupcionit. *"Korrupcioni nuk ka depërtuar aq, e as që është ngulitur aq thellë saqë t'i bëjë përpjekjet kundër korrupcionit të pashpresa,"* konkludon raporti i UNDP-së.

Luftimi i korrupcionit

Në mars të vitit 2004, Qeveria e kishte miratuar "Strategjinë Anti-Korrupcion" të elaboruar mirë, e cila është ambicioze dhe e gjithanshme. Strategjia Anti-Korrupcion e Qeverisë, kohëve të fundit është vënë në praktikë përmes Planit të Veprimit për Anti-Korrupcion, një matricë të detajuar 25 faqeshe të masave që lidhen me grupet e pikësynuara dhe bartësit, përgjegjësitë, afatet kohore, treguesit e suksesit, pengesat dhe sfidat. Plani i Veprimit ka për synim legjislacionin e ri, zbatimin e ligjit, vetëdijësimin e publikut dhe përfshirjen e shoqërisë civile, dhe duhet të realizohet gjatë viteve 2006-2007. Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit është duke i koordinuar dhe mbikëqyrur këto iniciativa.

Duke marrë parasysh Planin e Veprimit të Qeverisë dhe instrumentet tjera ekzistuese kundër korrupcionit, mund të prezantohet kjo pasqyrë e përgjithshme e iniciativave për luftimin e korrupcionit në Kosovën e sotme.

Masat Legjislative Anti-Korrupcion

Si pjesë e Strategjisë Anti-Korrupcion, Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për Anti-Korrupcion në prill të vitit 2005, i cili u shpall nga PSSP-ja në maj të vitit 2005. Ligji parasheh masa kundër korrupcionit në fushën e hetimeve administrative të korrupcionit publik, publikimin e shkeljeve

më serioze të ligjit, nepotizmit në rekrutim, konfliktit të interesave, standardet në dhënien/ marrjen e dhuratave në administratën publike, etj.. Po ashtu ligji parasheh themelimin e Agjencisë Kosovare të Anti-Korrupcionit. Kjo Agjenci Ekzekutive do ta ketë një Këshill - i cili do ta mbikëqyrë punën e saj. Në shkurt të vitit 2006 në Kuvend është votuar për anëtarësinë e Këshillit të Agjencisë së Anti-Korrupcionit. Funksionimi efikas i Këshillit Anti-Korrupcion do të mbikëqyrët nga afër, me siguri nga njëri prej Komisioneve të Kuvendit të Kosovës.

Shumë rregullore dhe ligje të kohëve të fundit janë relevante për politikat e anti-korrupcionit, siç janë Ligji për Investimet e Huaja, mbi Tranaksionet e Pagesave; mbi Standardet e Raportimit Financiar; mbi Likujdimin dhe Riorganizimin e Personave Juridik në Tranformimin e Bankrotimit. Sa i përket problemeve me procedurat e tenderimit duhet t'i referohemi rishikimit të propozuar së fundi të Ligjit të Prokurimit Publik. Rishikimi pasqyron standardet e BE-së në definimin e ndarjes së qartë ndërmjet funksioneve ekzekutive dhe rregullatore dhe ende duhet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës.

Përveç kësaj, Plani i Veprimit Anti-Korrupcion i Qeverisë, mes tjerash, parasheh legjislacion i cili mundëson financim ekstra-buxhetor të organeve të administratës publike me procedura të caktuara të auditimit, ligjin mbi financimin e partive politike, ligjin mbi pengimin e pastrimit të parave, legjislacion të gjithanshëm mbi tregun e aksioneve, sigurimeve dhe lojërave të fatit, sistemin bankar dhe kontabilitetin, ligjin mbi konfliktin e interesave, ligjin mbi konkurencën ekonomike, kartelet, monopolin dhe kurdisjen e çmimeve, legjislacionin sekondar mbi mbrojtjen e 'dëshmitarëve dhe të denoncuesve'. Po ashtu, Qeveria ka ndërmend të analizojë në mënyrë sistematike legjislacionin ekzistues dhe atë të propozuar sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin anti-korrupcion.

Masat Gjyqësore dhe Zbatimi i Ligjit

Që nga viti 2003, Njësia e Hetimeve Financiare (NjHF), e plotësuar me kuadro nga zyrtarët italianë të *Guardia di Finanza-s*, e ka mandatin të kryejë inspektimet financiare të organeve publike dhe të ndërmarrjeve publike, si dhe të organizatave të tjera të cilat marrin fonde publike, po ashtu edhe të nisë hetime penale. NjHF-ja është njësi e specializuar për zbatim të ligjit me kompetenca të plota policore që heton dhe ndjek penalisht për korrupcion dhe krimet e tjera ekonomike publike dhe subjektet e financuara nga publiku. Sipas Zyrës Evropiane të Kundër-Mashtrimit (ZEKM) dhe Shtyllës I të UNMIK-ut, *Guardia di Finanzia* është shërbimi policor i BE-së i kualifikuar, me përvojë dhe i specializuar në mënyrë më të përshtatshme për të operuar NjHF-në në Kosovë. NjHF-ja operon sipas kompetencave të rezervuara të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve nën Rezolutën 1244 të KSKB-ve.

Plani i Veprimit Anti-Korrupcion i Qeverisë parasheh një sërë masash për të forcuar sistemin gjyqësor në trajtimin e sfidave të korrupcionit, mes tjerash, fuqizimin e pozitës së prokurorit publik në procedurat hetimore paragjyqësore ndaj korrupcionit, t'u ofrojë këshilla mbi politikat agjencive përkatëse duke iu referuar forcimit të procesit të reformës së gjyqësorit dhe sigurimit të kualifikimeve të tyre të duhura, rishikimin e sistemeve të kompesimit pë zyrtarët e policisë, prokurorët publikë dhe gjykatësit.

Masat e Reformës në Administratën Publike

Komponente jetike e një strategjie efikase anti-korrupcion është krijimi i mekanizmave funksional të ankimimit dhe të procedurave të parashtresave në sferën e administratës civile. Përkitazi me nëpunësit e lartë publik nëpër ministri, është themeluar Komisionin për Emërime të Larta Publike (KELP) dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës (KPM).

Plani i Veprimit Anti-Korrupcion i Qeverisë parasheh iniciativa për të siguruar dhe mbrojtur pavarësinë dhe autonominë e këtyre organeve. Po ashtu, ky plan parasheh hartimin e rregullave të brendshme për raportimin e akteve të korrupcionit në kuadër të organeve të administratës publike, duke krijuar ose emëruar organe të cilat do të vendosin mbi shkeljet e kodit të etikës, si dhe për shfrytëzimin konsekuent të tenderave publik në administratën e personelit për postet e larta profesionale në administratë dhe në ndërmarrjet publike.

Public Finance and Economy Measures

Transparenca dhe llogaridhënia në trajtimin e financave publike janë me rëndësi kyçe për çdo strategji anti-korrupcioni. Plani i Veprimit Anti-Korrupcion i Qeverisë i kushton një kapitull të veçantë kësaj, dhe mes tjerash, parasheh iniciativa për t'i inkurajuar/obliguar bizneset që të punojnë me fatura, për t'i lidhur të gjitha bizneset me Administratën Tatimore të Kosovës përmes një sistemi elektronik të faturimit dhe analizat periodike të procedurave për aranzhimet publike, ndihmesën dypalëshe dhe shumëpalëshe, subvencionet, huatë dhe shfrytëzimet tjera të fondeve publike.

Në vijë me propozimet e kohëve të fundit të Transparency International-it, sugjerohet inicimi i "marrëveshjeve të integritetit" ndërmjet administratës së Kosovës dhe përfituesve të fondeve publike. Që do të thotë se nënshkruhet një marrëveshje ndërmjet administratës dhe kryeshefit ekzekutiv (KShE) të ofertuesit që të mos paguajë ose ofrojë kurrëfarë ryshfetesh. Ofertuesit që e shkelin zotimin e tyre do të sanksionohen me humbje të kontratës, detyrime për dëmtimet dhe se qeveria mund po ashtu që shkelësin ta vë në listë të zezë lidhur me të gjitha punët qeveritare për një periudhë të caktuar kohore.

Zyra e Revizorit të Përgjithshëm është institucion i Kosovës sipas Kornizës Kushtetuese, i themeluar në vitin 2003, i cili i vlerëson dhe bën revizionin e shpenzimeve nga organizatat buxhetore që janë nën Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës (BKK). Gjatë vitit 2005, Zyra e Revizorit të Përgjithshëm ka kryer revizione të kufizuara të prokurimit dhe të menaxhimit të mjeteve themelore në shumicën e komunave dhe në disa ministri. Zyra e Revizorit të Përgjithshëm ka realizuar një revizion të gjërë të BKK-së së vitit 2004, të publikuar në shkurt të vitit 2006. Plani i Veprimit Anti-Korrupcion i Qeverisë pret që Revizori i Përgjithshëm të kryejë revizionet financiare të agjencive qeveritare (në zhvillim e sipër në Kuvendin e Kosovës) dhe të korporatave publike (PTK, KEK, RTK, etj.).

Mediat, Shoqëria Civile dhe Pjesëmarrja e Publikut

Ngritja e vetëdijës së publikut është një element shumë i rëndësishëm i fushatës anti-korrupcion. Në bazë të Ligjit mbi Qasjen Publike në Dokumentet Zyrtare, shoqëria civile dhe gazetarët mund të grumbullojnë shumë informata relevante për identifikimin e modeleve të mundshme të korrupcionit. Legjislacioni sekondar që mundëson implementimin efikas të Ligjit është nxjerrë kohëve të fundit.

Forcimi i gazetarisë hulumtuese është jetike për t'i xjerrë në pah rastet e korrupcionit. Në Planin e Veprimit Anti-Korrupcion të Qeverisë përmenden analizat e mundësive ligjore për forcimin e pozitës së pavarur të gazetarëve dhe thekson përgjegjësinë e tyre në rastet e shkeljeve të ligjit.

Një pjesë tjetër qenësore në parandalimin e korrupcionit është përfshirja e shoqërisë civile në fushatën me bazë të gjërë të anti-korrupcionit. Komunat mund të zhvillojnë konsultime për të miratuar dhe zbatuar plane veprimi anti-korrupcion. Fushata mund të përqëndrohet në

grumbullimin dhe shpërndarjen e të dhënave të sakta përkitazi me korrupcionin në një zonë lokale. UNDP-ja po ashtu sugjeron realizimin e aktiviteteve të kontaktimit me publikun për të rritur legjitimitetin e IPVQ-ve kundrejt komunitetit serb të Kosovës.

Zbatimi i Planit të Veprimit

Plani i Veprimit Anti-Korrupcion i Qeverisë është i gjithanshëm dhe i bazuar në konsultime të gjëra në arenën politike dhe me organizatat e specializuara ndërkombëtare që punojnë në Kosovë. Megjithatë, zbatimi i tij i plotë nuk është i garantuar. Do të kërkojë vënien në dispozicion të fondeve të nevojshme, dhe se zotimi politik dhe interesi në kuadër të IPVQ-ve të mbahet dhe të rritet. Identifikimi i resurseve të kualifikuara njerëzore dhe i koordinimit të duhur ndërmjet institucioneve të përgjegjëse do të jetë i nevojshëm për të mbajtur afatin kohor të zbatimit deri në fund të vitit 2007.

Vetëvetiu nënkuptohet se trajtimi i shkaqeve themelore të modeleve të korrupcionit është jetik për të siguruar qëndrueshmërinë e të gjitha iniciativave të përmendura anti-korrupcion. Për të përmirësuar situatën ekonomike në Kosovë është kusht mundësimi i trajtimit të shkaqeve themelore të korrupcionit. Praktikisht, kjo do të thotë mundësimin e pagave të nëpunësve të lartë publik, fonde më të pikësynuara të ndërmarrësve të Kosovës dhe zhvillimin e shkathtësive komerciale të të rinjëve të Kosovës. Qasje të përmirësuar në shërbimet publike të cilësisë më të lartë siç janë kujdesi shëndetësor primar dhe arsimi janë jetike për trajtimin e kushteve që gjenerojnë korrupcion në shoqërinë e Kosovës.

"Politikat e Llogaridhënies" si Qasje e Bashkësisë Ndërkombëtare në Kosovë

Kosovo has a complex governing structure, with local and international actors having Kosova ka një strukturë qeverisëse komplekse, me aktorë vendorë e ndërkombëtarë, të cilët kanë mandate të cilat nganjëherë e mbulojnë njëra tjetrën ose janë të paqarta. Si rrjedhojë, qytetarët nuk janë gjithmonë në gjendje të përcaktojnë se kë ta mbajnë përgjegjës për pohimet për korrupcion.

Si pjesë e procesit të demokratizimit në Kosovë, bashkësia ndërkombëtare përkrah iniciativat antikorrupcion të IPVQ-së. Mirëpo, ia vlen të merren parasysh përvojat në Bosnje dhe Hercegovinë ku procesi i imponimit të shpeshtë të vendimeve të cilat bashkësia ndërkombëtare mendon se janë në interes të publikut po vlerësohet se po bëjnë pak për të promovuar synimet e demokratizimit, qoftë në forcimin e institucioneve politike ose nxitjen e pjesëmarrjes së publikut në sferën politike. Në një artikull mbi strategjinë anti-korrupcion dhe demokratizimin në Bosnje dhe Hercegovinë, David Chandler paralamëron se *"strategjitë anti-korrupcion lehtë mund t'i neglizhojnë realitetet politike të ndërtimit të koalicionit – dhe konsensusit të domosdoshëm për jetën politike. Interesi publik modelohet përmes procesit demokratik dhe nuk është diçka që mund të vendosed ose definohet nga një administrator ndërkombëtar, pa marrë parasysh sa janë qëllim-mira."* Autori thekson se procesi i imponimit të politikave nga jashtë mbi përfaqësuesit politik, përmes sanksioneve ekonomike dhe shkarkimit të zyrtarëve të zgjedhur mosbashkëpunues siguron se nuk ekziston mundësia e nxjerrjes në pah të interesit të publikut, pasi që nuk ekziston negociimi ndërmjet përfaqësuesve.

Duke marrë parasysh "mësimet e nxjerra" nga politika intervencioniste në Bosnje dhe Hercegovinë, bashkësia ndërkombëtare ka marrë një qasje më të kujdesshme në Kosovë. Sanksionet ekonomike dhe shkarkimi i zyrtarëve të zgjedhur mosbashkëpunues rrallëherë ndodh në Kosovë. Në vend të kësaj, është shpalosur një grup i kombinuar i politikave, me

synim ndërtimin e kapacitetit, vendosjes së një kornize ligjore të gjithanshme dhe të sigurimit të llogaridhënies.

Me qëllim të zhvillimit të një kornize për të përmirësuar funksionimin e shoqërisë dhe ngritjen e kushteve të jetesës, janë dizajnuar një seri "Standardesh". Implementimi i standardeve ka për synim t'i japë drejtim zhvillimit të shoqërisë në vitet që do të vijnë.

"Politika e llogaridhënies" që është aktualisht në Kosovë e mat progresin, arritjet dhe pengesat në implementimin e standardeve të qeverisjes së mirë. Politika e llogaridhënies synon t'i inkurajojë IPVQ-të që të marrin udhëheqjen në krijimin dhe zbatimin e politikave, gjersa i mban përgjegjëse IPVQ-të për standardet specifike të qeverisjes së mirë dhe të respektimit të të drejtave të pakicave. Bashkësia ndërkombëtare e monitoron performancën e IPVQ-ve, ndihmon në ndërtimin e kapaciteteve të strukturave të tyre, këshillon mbi politikat dhe kornizat e politikave, dhe – vetëm si masë e fundit – ndërhyn në raste të caktuara. Supozimi që qëndron në thelb të politikës së llogaridhënies është se pronësia vendore është absolutisht qenësore për qendrueshmërinë e qeverisjes në Kosovë.

Si pjesë e procesit në përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, një prani ndërkombëtare civile do të vazhdojë të operojë në Kosovë që vitet që do të vijnë. Prania ndërkombëtare civile do të operojë brenda kornizës së vendimeve që do të merren nga Këshilli i Sigurimit të Kombëve të Bashkuara më vonë këtë vit. Konsultimet paraprake ndërmjet UNMIK-ut, BE-së, OSBE-së dhe NATO-s/KFOR-it japin indikacione se sipas të gjitha gjasave prania e ardhshme ndërkombëtare civile do të jetë një prani e lehtë që do të punojë me popullin, udhëheqësit dhe institucionet e Kosovës. Prioritet kyç për praninë e ardhshme, pas implementimit të zgjidhjes së statusit, do të jetë puna me institucionet në përmbushje të Standardeve në vijë me politikën e llogaridhënies.

Në këtë kornizë, është e mundur që do të ketë nevojë për prani ndërkombëtare policore në Kosovë, për një periudhë të kufizuar kohore, përtej përcaktimit të statusit. Prania e tillë pastaj do të fokusohej në disa fusha kyçe, siç janë: ndër të tjera, krimi i organizuar dhe niveli i lartë i korrupcionit. Aktualisht BE-ja është duke i shikuar resurset dhe afatet kohore për dislokimin e një force policore të BE-së në Kosovë, e cila gradualisht do të merrte përsipër aktivitetet nga policia aktuale ndërkombëtare e UNMIK-ut.

Vazhdimi i pranisë së gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë mund të jetë qenësor në fushat e këtilla të ndjeshme për një periudhë të ardhshme të caktuar. Këta ndërkombëtarë do të merren me rastet e ndjeshme të cilat gjyqësori vendor ende nuk është në gjendje t'i trajtojë, ndërkaq po ashtu të ndërtojë kapacitetet e prokurorëve dhe gjykatësve të përzgjedhur vendorë për t'u marrë me këto raste në të ardhmen.

Përmes politikës së llogaridhënies, bashkësia ndërkombëtare në Kosovë përpiqet t'i garantojë disa standarde të sundimit të ligjit dhe të funksionimit demokratik. Në këtë kornizë, i jepet përkrahje dhe këshilla IPVQ-ve në iniciativat e veta të anti-korrupcionit. Transicioni në një prani të ardhshme ndërkombëtare civile sipas të gjitha gjasave do të vazhdojnë të vënë theksin në masat anti-korrupcion, ashtu siç janë përvijuar në Planin e Veprimit Anti-Korrupcion të Qeverisë, mirëpo, me udhëheqje të vendosur dhe përgjegjegjësi të IPVQ-ve. Siç ndodh edhe me vendet e tjera të Ballkanit, implementimi efikas i politikës anti-korrupcion është vetëm njëra nga konsideratat kyçe për BE-në që të fillojë parashikimin e hyrjes efikase në BE. Me konsensusin në mbarë Kosovën përkitazi me synimin për t'u integruar në BE, anti-korrupcioni duhet të mbetë lart në agjendën e institucioneve politike, të administratës dhe gjyqësorit, shoqërisë civile, mediave dhe popullit të Kosovës përgjithësisht.

Bibliografia

CARVER, Jeremy, Combating Corruption: the Emergence of New International Law, in: International Law Forum / Forum du Droit International, 2003/ 5: pp. 119-223.

CHANDLER, David, Anti-Corruption Strategies and Democratization in Bosnia-Hercegovina, in: Democratization, Vol. 9, No. 2, Summer 2002, pp. 101-120.

- DE VRIEZE, Franklin, Kosovo after the March 2004 Crisis, Helsinki Monitor, No.3, 2004, 20 p.

EUROPEAN STABILITY INITIATIVE, Towards a Kosovo Development plan, The State of the Kosovo Economy and possible Ways Forwards, August 2004, 35 pg., http://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_58.pdf

FATIC, Alexandar, Anti-corruption and anti-organized crime in Serbia: regional implications, in: Journal of Southeast European and Black Sea Studies, Vol. 4, No.2, May 2004, pp. 315-324.

GALTUNG, Fredrik, Criteria for Sustainable Corruption Control, in: European Journal of Development Research, 1997, pp. 105-128.

INTERNATIONAL CRISIS GROUP, Kosovo After Haradinaj, Europe Report 163, 26 May 2005, www.crisisweb.org

INTERNATIONAL CRISIS GROUP, Kosovo: The Challenge of Transition, Europe Report 170, 17 February 2006, www.crisisweb.org

OFFICE OF PRIME MINISTER, Anti-Corruption Action Plan in Kosovo, January 2006, 25 pg.

SOFRONIEV, Serafim, Office of the Auditor General: a Central Pillar for Public Accountability, in: Assembly Support Initiative Newsletter, No. 21, February 2006, p. 14 – 15, www.osce.org/kosovo

SPECTOR, Bertram, Assessment of Corruption in Kosovo, 10 July 2003, Submitted by Management Systems International to USAID, 44 pg, www.usaid.gov

TRANSPARENCY INTERNATIONAL, Corruption Perceptions Index, www.transparency.org

TRANSPARENCY INTERNATIONAL, Global Corruption Barometer, www.transparency.org

U.S. DEPARTMENT OF STATE, 2006 Investment Climate Statement Kosovo, http://www.state.gov/e/eb/ifd/2006/62006.htm

UNDP, Combating Corruption in Kosovo. A Citizens' Perceptions Survey in Support of the Kosovo Anti-Corruption Strategy, 2004, 32 pg., www.undp.org

UNDP, Kosovo Early Warning Reports, 2001 – 2005, www.undp.org

Rreziku nga Korrupsioni: Mendime dhe Realiteti

Habit HAJREDINI, Drejtor,

Zyra për Qeverisje të Mirë

Kosova është sprovuar me transformim të konsiderueshëm në shtrirjen e saj ekonomike dhe politike. Banorët e Kosovës, Qeveria dhe Bashkësia Ndërkombëtare duket së është e përkushtuar për të zvogëluar Korrupsionin. Shpejtësia e ndryshimeve nuk është edhe aq e shpejt, barra ekonomike, shoqërore dhe mbi të gjitha ajo politike, siç është statusi politik, pavarësia dhe funksionimi i institucioneve është objektiv përmbajtjesor i asaj.

Rreziku

Situata e tanishme politike dhe ekonomike në vend inkurajon deri në një shkallë rrezikun nga korrupsioni, dhe se shoqëria civile dhe media të lira nuk janë mjaft të fuqishme dhe prandaj nuk mund të bartin përgjegjësi të plotë për të luftuar korrupsionin. Rreziku vjen nga **ekonomia** (privatizim i gjerë, denacionalizimi, rregullat ende të pa rregulluara të tregut), **Papunsia e madhe**, **mungesa e tregut të lir**ë, (monopoleve, aksionet e kompanive shtetërore, dhe aktivitete nga ekonomia e pa rregulluar); **por po ashtu edhe nga dobësia e përgjithshme e institucioneve** (klientizmi, nepotizmi, formalizmi, burokracia) dhe paqëndrueshmëri e përgjithshme e normave shoqërore (punësimi i lart, shpërthim i konsumit dhe i aspiratave, mungesa e orientimit). Fenomeni i korrupsionit reflekton dhimbjen e cila është në rritje nga demokracia e re, nuk është incident por pengesë e përhershme dhe pjesë e sistemit.

Problemi unik i Kosovës është se ka status të paqartë politike. Problemi është barrë e një të kaluare totalitare, ndarja e kaluar në baza të përkatësisë etnike, por po ashtu edhe menaxhimi dhe kontrolli ndërkombëtarë. Mungesa e besimit në institucionet lokale të një qëndrimi të shfaqur dobët është racionalist i një vendim politik, përndryshe, kjo qon drejt një zhvillimi të pasivitetit dhe një efikasiteti esencial të institucioneve lokale me caqet e tyre të ligjshme, përgjegjësit drejt elektoratit, meritat profesionale dhe besueshmëria.

Në këtë perspektiv korrupsioni është një problem real i Kosovës. Mos rregullimin e zgjedhjeve publike, skandalet në media apo mbikëqyrës të jashtëm. Fakti që ne nuk mund të masim se sa në fakt korrupsioni është i përhapur në Kosovë nuk do me thënë se ne nuk jemi të sigurt se pengon biznesin dhe se përshtypja e gjithëpërfshirëse e cila mënjanon investitorët e huaj dhe ndërmarrësit lokal. Veç kësaj, çdo relativitet shumë dëmton sepse krijon një arsye të mundshme nga mungesa e vendosmërisë politike në zbatimin e masave: pyetje rreth asaj se a trashëgohet korrupsioni apo krijohet, se a është një erozion moralesh dhe se kush duhet të fajësohet më tepër nuk është çështje, por gjëja me rëndësi është se çfarë është duke u bërë për të eliminuar korrupsionin. Ne jemi të vetëdijshëm për barrën nga traditat – gjurmët të lëna nga sitetmet e mëhershme politike, veçanërisht ato të errëta: privilegjet e dhëna atyre të cilat janë të dëgjueshme, mundësia për të grabitur në emër të idealeve, fakti se çdo gjë mund të bëhet përmes lidhjeve dhe ndikimeve, se për ata në fuqi besnikëria dhe dëgjueshmëria donë të thotë më tepër se puna dhe risit. Ne dimë se vendet e tjera kanë probleme të ngjashme; ne dimë se korrupsioni kurrë nuk do të mund që krejtësisht të çrrënjoset, por jemi të sigurt se ne nuk mund të mbesim pasiv dhe të presim.

Korrupsioni dhe Origjina e tij

Korrupsioni ka qene pjese e shoqëris që në fillimet e saj. Ajo ka qenë pjesë përbërese e aktiviteteve tona kolektive gjatë gjithë koherave. Arsyeja përse ne i kushtojm kohë studimit të korrupsionit si praktikë është sepse ai jo vetem që gerryn përbërjen ekonomike të shoqërisë por i më dinamit thëmeleve morale të rendit në një vend.
C'do të thotë "korruptoj" – Korruptoj do të thotë të prishësh dike nga ana morale për qëllime të caktuara; të shtysh dikë me anë ryshfetësh etj, të shkelësh ligjet ose të veprosh në kundërshtim me detyren që ka, për të bëre sherbime.
Përkufizimet për termin "korrupsion" janë të shumta. Në shumicen e rasteve përkufizimi i termit mban dhe koliritin e vendit ku përdoret.

Shumë autorë e kanë krahasuar korrupsionin me faullin në futboll. Aktet korruptive sistematike gjenerojnë kosto ekonomike duke eliminuar inisiativat pozitive, kosto politike duke minuar Institucionet dhe kosto sociale duke bërë rishpërndarjen e pasurise tek ata që nuk e meritojnë. Kur korrupsioni minon të drejtat e pronës, forca e ligjit, inisiativat për të investuar si dhe zhvillimet ekonomike dhe sociale tkurren. Korrupsioni ekziston në mbarë botën. Por Korrupsioni tenton të jetë me shkatërrues ndaj vendeve të varfëra ku mund të minojë ceshtjen e të drejtave të pronës, ligjit dhe inisiativave për të investuar.

Përse është korrupsioni një cështje kaq madhore në botë sot?

Ka shumë arsye por le të rendisim disa prej tyre: Një mundësi është se korrupsioni është keqësuar duke cuar në një pakënaqësi më të madhe publike. Keqësimi mund të vije nga fakti se është rritur tregetia ndërkombëtare dhe komunikimi me botën, e si rrjedhojë njerezit dhe nëpunësit civil ekspozohen ndaj mundësive ekonomike të pamenduara më parë (dhënia e licensave ndaj të huajve). Në shumicën e rasteve korrupsioni ndodh sepse ndryshimet që zbatohen nga Institucionet që janë "të sëmura" nuk cojnë në një konkurencë të ndershme por në marreveshje të brendshme të pista e në trafikim politik. Mundet që korrupsioni është në të njejtat nivele si më parë por ka ndryshuar ndërgjegjëja jonë dhe toleranca ndaj ketyre praktikave. Një tjetër arsye mund të jetë se njerezit gjejnë qetësi kur fajesojne korrupsionin pasi reformat ekonomike dhe ato demokratike nuk kanë realizuar ato që ata prisnin nga këto zhvillime e reforma.

Në kuadër të ndërtimit të një shoqërie demokratike në Kosovë, institucioneve demokratike dhe funksionale, sundimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës, luftimi dhe parandalimi i korrupsionit si formë e krimit të organizuar, përbejnë një nga prioritetet e programeve të Qeverisë, si një prej kushteve më themelore për krijimin e shtetit ligjor, institucioneve funksionale dhe shoqërisë demokratike.

Në këtë kontekste është duke bashkëpunuar në shkallë të gjerë me institucione, agjenci, donatorë, organizata ndërkombëtare dhe OJQ vendore, për të adresuar korrupsionin në nivelin kombëtar dhe regjional dhe po punon për të zvogëluar mundësitë për korrupsion përmes hartimit të politikave,krijimin e mekanizmave dhe përkrahjen e aktiviteteve mbikëqyrëse, si dhe edukimin e qytetarëve për rolin e tyre në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Kontrollimi i korrupsionit është pjesë esenciale e qeverisjes së mirë, dhe është një sfide e madhe për qeveritë në gjithë botën. Shpesh në vendet në tranzicion korrupsioni shfaqet si një fenomen i zakonshëm në jetën e qytetarëve, dhe kjo paraqet pengesë serioze përfunksionimin e institucioneve publike.

Në Kosovë, korrupsioni nuk ka depërtuar dhe nuk është rrënjosur aq thellë sa të bëjë të kota përpjekjet tona kundër korrupsionit. Edhe hulumtimet e bëra tregojnë së qytetaret e Kosovës, pavarësisht nga përkatësia etnike ose statusi socioekonomik, përgjithësisht mendojnë se korrupsioni është një sjellje e papranueshme.

Ne këtë mënyre, Qeveria e Kosovës më politikat e saj në luftimin e korrupsionit dhe parandalimit të tij i është qasur ne disa drejtime:

a. përmes krijimit të legjislacionit;
b. edukimit (ngritjen e vetëdijesimit të opinionit publik) dhe
c. krijimit të mekanizmave për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Në ketë kuadër tanimë janë krijuar disa mekanizma dhe janë ndërmarre hapa konkret që do të mundësojnë një luftim adekuat të fenomenit të korrupsionit.

Rendësi i është kushtuar edhe zhvillimin dhe përsosjes se sistemeve për rritjen e transparencës, dhe llogaridhënies të institucioneve Qeveritare *Për rritjen e transparencës si një nder faktorët* parandalues të korrupsionit, Qeveria ka aprovuar Udhëzimin Administrative mbi zbatimin e Ligjit mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare.

Çrrënjosja e korrupsionit në Kosovë do të përfshijë jo vetëm reformat institucionale dhe legjislative, por gjithashtu edhe një angazhim afatgjatë për të ndryshuar kulturën ndaj korrupsionit në Kosovë. Përpjekjet për të zvogëluar atë, do të jenë plotësisht të integruara në prioritetet e Qeverisë së Kosovës përgjatë të gjithë sektorëve te saj.

Qeveria e Kosovës dhe kosovarët e kuptojnë se përpjekjet kundër korrupsionit duhet të përfshijnë shumë aktorë në marrjen e përgjegjësive për të adresuar aspekte të veçanta të këtij problemi kompleks, nga një bashkëpunim real i të gjithë forcave të shoqërisë, si të sektorit publike, sektorit privat, shoqërisë civile e të gjithë aktoreve të tjerë të rëndësishëm.

Duke pasur parasysh rëndësinë e ndërtimit të një shoqërie demokratike në Kosovë, përfaqësimit të drejtë të vullnetit te popullit të Kosovës në procesin e ngritjes dhe zhvillimit të institucioneve demokratike dhe funksionale, sundimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës, sigurimin e trajtimit të barabartë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe nxjerrjes të rregullave në përputhje me standardet dhe normat përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare, Qeveria e Kosovës ka pranuan nevojën për krijimin e instrumenteve ligjore dhe politikave qeveritare për një shoqëri ku do të mbretëroj barazia efektive para ligjit për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Një prej sfidave dhe rreziqeve më të mëdha që sulmon një shoqëri demokratike dhe sundimin e ligjit të një vendi është fenomeni korrupsion. Kontrollimi i korrupsionit është pjesë esenciale e qeverisjes së mire dhe është një sfide e madhe për qeveritë në të gjithë vendet. Luftimi dhe parandalimi i korrupsionit si formë e krimit të organizuar, përbejnë një nga prioritetet e programit të Qeverisë se Kosovës.

Zyra për Qeverisje të Mirë pran Zyrës se Kryeministrit si pjesë e Degës Ekzekutive të Kosovës, është e mandatuar në mbikëqyrjen dhe këshillimin të ministrive, krijim të politikave dhe veprimit në sferat e qeverisjes së mirë, në të drejtat e njeriut, në mundësitë e barabarta dhe në çështjet gjinore si dhe këshillimin dhe rekomandimin e Kryeministrit të Kosovës dhe ministrive përkatëse në politikat e lartcekura, ka pasur rolin kyç në udhëheqjen e aktiviteteve kundër korrupsionit në kuadër të IPVQ-ve si dhe qeverisë në përgjithësi.

KRIJIMI I MEKANIZMAVE INSTITUCIONAL ANTI-KORRUPCION NE KOSOVE

The institutions of Kosovo have undertaken concrete steps on issues related to prevention and combating corruption as follows:

1. Hartimin e Strategjisë kundërkorrupsionit
2. Themelimin dhe funkësionimin e grupit punues ndërministrore antikorrupsion
3. Legjislacioni antikorrupsion
4. Plani i veprimit kundër korrupsionit
5. Fushata publike kundërkorrupsionit
6. Agjensioni antikorrupsion

Strategjia kundërkorrupsionit

Qeveria e Kosovës në mars të 2004 ka aprovuar strategjinë kundër korrupsionit, nën kordinimin e Zyres për Qeverisje të Mirë/ZKM, grupit punues, strukturave të UNMIK, agjensive ndërkombetare, dhe shoqërisë civile është hartuar strategjia kundërkorrupsionit në Kosovë. Strategjia parasheh mëse 150masa parandaluese duke përfshirë fushën ekonomike, legjislacionin, administraten publike, politike, mediat, shoqërin civile etj..

Grupi punues ndërministror kundër korrupsionit

Me vendimin e qeverisë të datës 9.10.2003 është formuar grupi punues ndërministror kundër korrupsiojnit,grupi përfaqsohet nga te gjitha ministrit në Qeveri duke perfshi edhe krijimin e ministrive te reja,sidhe departamentin e drjtësis dhe zyren ligjore UNMIK. Grupi punues i udhëhequr nga drejtori i ZQM/ZKM ka për qëllim të hartojë politika dhe strategji kundër korrupsionit.

Ligji kundër korrupsionit

Qeveria e Kosovës aprovojë ligjin kundër korrupcionit, po ashtu ky ligjë është inicuar nga ZQM/ZKM përkrahur dhe ndihmuar nga agjensioni evropian, GTZ, ekspert vendorë dhe ndërkombëtar. Në shtator 2004 parlamenti aprovojë ligjin kundër korrupsionit, dhe eshte nëshkruar nga PSSP.

Plani i veprimit kundër korrupcionit

Zyra për Qqeverisje të Mirë/ZKM ka marrë përsipër të hartoje planin e veprimit kundër korrupsionit, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, strukturat e UNMIK, dhe Shoqëria Civile.Gjithashtu , më 25/26 tetor 2004 ZQM/ZKM,në bashkëpunim me projektin Paco Impact të Këshillit të Evropës, është organiuar një puntori dy ditore për zhvillimin e Planit të Veprimit për Implementimin e Strategjisë kundër korrupsionit në Kosovë, drafti i parë i këtij plan veprimi është prezentuar më 21/22 shkurt 2005, në këto puntori të mbajtura deri me tani kan kontribuar ekspert vendorë dhe ndërkombetare. Plani i veprimit kundër korrupcionit ne Kosove eshte aprovuar nga këshilli iministrave, plani ka për qellim që të bëj implementimin e strategjisë kundër korrupcionit, plani i veprimit parasheh objektiva dhe veprime konkrete për të parandaluar dhe luftuar korrupcionin, definon institucionet përgjegjëse, kohen për të kryer detyrat dhe indikatorët esuksesit.

Fushata publike kundër korrupcionit

Zyra për Qeverisje të Mirë e Kryeministrit dhe partnerët e saj kanë lansuar një kampanjë të gjërë kundër korrupcionit që përforcon rolin e sherbysëve civilë dhe qytetarëve të zakonshëm në luftimin e korrupsionit. Fushata është një aspekt kyq iqasjes së shumëanshme ndaj luftimit të korrupsionit . Fushata udhëheqet nga një këshillë drejtues nën udhëheqjen e ZQM/ZKM dhe një bashkëudhëheqes nga Shoqëria civile. Këshilli drejtues, paraqet një nivel të paraparë të bashkëpunimit mes akterëve të ndryshëm me interes të luftimit të korrupsionit në Kosovë, duke përfsirë liderët mbrenda qeverisë dhe shoqërisë civile. Fushata publikr kundër korrupcionit ka për qëllim të ndihmojë ne implementin e strategjisë kunder korrupsionit, për këtë janë ngritë nëngrupe për të dizajnuar dhe kryer aktivitete në fushat si avokimi, edukimi, nënivel komunal dhe atë qendrore, po ashtu këto aktivitete po përfshinë fushat mediale të vetëdijesimit, trajnime me sherbyesit civilë, dhe forume në Komuna për të formuluar plane lokale të veprimit për të luftuar korrupsionin.

Këshilli i Agjencionit kundër-korrupcionit

Kuvendi i Kosovës në seancën e mbajtur më dt. 23 shkurt 2006 konform neni 19.2 të Ligjit kundër Korrupsionit mori Vendim (nr. 02-946-1/06) për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Agjensionit kundër korrupsion me mandat dy vjeçar.
Këshilli i Agjensionit themelohet për ushtrimin e mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë të Agjensionit. Këshilli i Agjensionit përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë, 3 (tre) emërohen nga Kuvendi dhe nga 1 (një) përfaqësues të emëruar nga Zyra e Presidentit, Qeveria, Gjykata Supreme, Zyra e Prokurorit Publik, autoritetet lokale dhe shoqëria civile. Këshilli i Agjensionit kontrollon në mënyrë të rregullt dhe të plotë punën e Agjensionit dhe mbikëqyrë pasuritë e personave zyrtarë që punojnë në Agjension. Drejtori i Agjensionit raporton tek Këshilli i Agjensionit çdo gjashtë muaj në lidhje me përmbajtjen dhe shtrirjen e mbikëqyrjes së pasurive si dhe për gjetjet e Agjensionit në lidhje me papajtueshmërinë, konfliktin e interesave, dhuratat dhe hetimet e përfunduara. Këshillit të Agjensionit i caktohen detyrat profesionale dhe i sigurohen kushtet teknike për kryerjen e punëve nga Agjensioni.

Agjencioni kunder-korrupcionit

Krijimi i mekanizmave për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit duke themeluar Agjensionin Kosovar kundër- Korrupsionit, i cili sipas ligjit kundër korrupsionit do të është agjension i pavarur. Kuvendi i Kosovës në seancen e mbajtur me datën 17 korrik 2006, konform ligjit kundër korrupsionit ka zgjedhur drejtorin e Agjensionit. Në bazë të nenit 51.2. Agjensioni do të fillojë funksionimin pas emërimit të drejtorit të saj.

Zyra e Kryeministrit, 10000 Prishtinë
Zyra për Qeverisje të Mirë, Drejtor Habit Hajredini
Tel: (+381-38) 200 140 70 Fax +381-38-200.146.43
kontakt: habit.hajredini@ks-gov.net

Selia e Misionit të OSBE-së, 10000 Prishtinë
Tel (+381.38) 500 162 Fax (+381.38) 500 188
kontakt: lodewijk.vanoost@osce.org
http:/www.osce.org/Kosovo